

9 000 maturantë do  
t'i nënshtrohen testit  
në afatin e dytë | FAQE 2




Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## AKTUALE

FANTAZMAT  
E NDARJES  
PO BEZDISIN  
BALLKANIN  
KËTË VERË | F.13



Nga Janusz BUGAJSKI

KOSNETTI THOTË SE KOSOVA  
DUHET T'I KETË FORCAT E  
ARMATOSURA PËR MBROJTJE | F.6

POLICIA SULMOHET ME  
NGJYRË, ARRESTOHEN TETË  
AKTIVISTË TË  
VETËVENDOSJES | F.6

## EKONOMI

AKTAKUZË NDAJ AGRON  
MUSTAFËS, EJUP QERIMIT  
DHE REXHË GJONBALAJT | F.9

## KULTURË

DOKSA DHE  
NËNKUPTIMI  
SI ELEMENTË  
PRAGMATIKË  
NË ANALIZËN  
ARGUMENTUESE | F.13



Nertila ZANI

## SPORT

LLUMNICA: KATËR SKUADRA  
LUFTOJNË PËR TITULL | F.16

KB PEJA: VENDIMI I FBK-së,  
SKANDALIZ | F.16

FLET PËR "EPOKËN E RE", ABELARD TAHIRI | FAQE 4-5

# Logjika e kërcënimit të institucioneve ka perënduar



Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka thënë se është më shumë se kurrë i fokusuar për fuqizimin e shtetit ligjor. Duke folur për dorëheqjen e prokurorit Elez Blakaj, për të cilin thuhet se ka ardhur për shkak të kërcënimit, ministri Tahiri ka theksuar kjo çështje mbetet për t'u sqaruar dhe janë të tjera organe ato që konstatojnë nëse ka pasur kërcënime. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se është e papranueshme që zyrtarët e institucioneve që zbatojnë ligjin të kërcënohen nga kushdo qoftë. "Mesazhi që unë kam përçuar dhe që i qëndroj plotësisht është se askush nuk është mbi ligjin dhe askush nuk do të duhej dhe nuk mund të shpresojë se Republika e Kosovës dhe institucionet e saj do të bien pre e presionit, kërcënimit apo shantazhit", ka thënë Tahiri, duke shtuar se mekanizmat e rendit dhe të ligjit kanë nevojë për koordinim edhe më të mirë

# Dëmet nga vërshimet në Therandë parashihen të jenë miliona euro

Kryetari i Komunës së Therandës, Bali Muharremaj, ka bërë me dije se dëmet nga vërshimet e fundit në këtë komunë parashihen të jenë miliona euro. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", në të cilën ka folur për pasojat e përmbytjeve nga reshjet e shiut, Muharremaj ka thënë se më të prekura janë rrugët, hapësirat bujqësore dhe katet përdhese të shtëpive. Përveç dëmeve materiale, ai ka treguar se lëndime kanë pësuar edhe dhjetë persona. Kryetari Muharremaj ka deklaruar se mundësitë e kësaj komune për t'u përballur me këto dëme janë të pakta. Prandaj, sipas tij, mbështetja e Qeverisë për Therandën është shumë e nevojshme | FAQE 3



Delawie tregon  
'vijat e kuqe' të  
ShBA-së për  
marrëveshjen  
finale me Serbinë | FAQE 2

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Kurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**SatStyro**  
Mushnikovë-Prizren-Kosovë  
Product of EPS and XPS  
Mob.: +377(0) 44 506 815  
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030  
e-mail: [sat\\_styro@yahoo.com](mailto:sat_styro@yahoo.com)  
[www.satstyro.com](http://www.satstyro.com)

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë, Greg Delawie, ka dalë me mesazh rreth procesit të dialogut Kosovë - Serbi

## Delawie tregon 'vijat e kuqe' të ShBA-së për marrëveshjen finale me Serbinë

Ambasadori i ShBA-së në Kosovë, Greg Delawie, ka folur lidhur me marrëveshjen në fazën finale të dialogut Kosovë - Serbi. Nëpërmjet një videomesazhi Delawie ka pohuar se janë të përkushtuar për sovranitetin e Kosovës. "Ne besojmë se thelbi i një marrëveshjeje Kosovë - Serbi duhet të vijë nga dialoguesit. Por, ka kufizime për atë që ne do të pranojmë. Jemi të përkushtuar për Kosovën. Jemi të përkushtuar për sovranitetin dhe suksesin ekonomik të saj", ka thënë Delawie, duke shtuar se janë të vetëdijshëm për rolin historik që ShBA-ja ka pasur për t'i dhënë fund konfliktit në përgjithësi në Ballkan, në veçanti në Kosovë



luajtur për t'i dhënë fund konfliktit në përgjithësi në Ballkan, në veçanti në Kosovë", ka deklaruar Delawie.

Ai ka thënë se ShBA-ja dëshiron ta ndihmojë Kosovën në arritjen e një marrëveshjeje me Serbinë. "Nuk duam të kthehen ditët e dikurshme, nuk duam të shohim një marrëveshjeje që do të krijonte më shumë probleme sesa që do të zgjidhte. Duam të ndihmojmë në arritjen e një marrëveshjeje të zbatueshme, të qëndrueshme dhe që i kontribuon stabilitetit në rajon. Çdo marrëveshjeje duhet të garantojë sigurinë për të gjithë qytetarët e saj, duke përfshirë grupet e pambrojtura, serbët e Kosovës dhe kishën ortodokse serbe. Javët e fundit ka pasur pak retorikë të padobishme, duke përfshirë edhe kërcënime dhe gjuhë të tillë që e

kemi dëgjuar gjatë ditëve të këqija të dikurshme të komunizmit. Kjo duhet të ndalohet. Deklaratat e tilla minojnë gjasat për zgjidhje dhe i ngrehin tensionet. Dhuna dhe kërcënimet për dhunë janë të papranueshme", ka thënë Delawie.

Ai ka shtuar se ShBA-ja do të qëndrojë përkrah Kosovës. "Ne do të qëndrojmë krah jush gjatë këtij rrugëtimit. Gjatë javëve të ardhshme dëshiroj t'ju njoftoj me disa prej diplomatëve të sapoardhur në Ambasadën tonë, të cilët i janë bashkuar ekipit tonë për të siguruar që partneriteti ynë me Kosovën mbetet i fuqishëm", ka theksuar Delawie.

**EPOKA E RE** Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 17 GUSHT - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Greg Delawie, ka thënë se vendi i tij ka disa kufizime se çfarë do të pranohet si marrëveshje ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit. Në një adresim për media, Delawie ka thënë të premten se ShBA-ja është e përkushtuar ndaj sovranitetit të Kosovës dhe se Uashingtoni nuk dëshiron ta shohë një marrëveshjeje që do të krijonte më shumë probleme sesa që do të zgjidhte. "Jam i lumtur që kaq shumë qytetarë të Kosovës tani po marrin pjesë në bisedat e rëndësishme për dialogun me Serbinë. Kjo është gjë e mirë. Megjithatë, dëshiroj t'i qartësoj disa gjëra. Ne besojmë se thelbi i marrëveshjes ndërm-

jet Kosovës dhe Serbisë duhet të vijë nga vetë palët. Por, ka kufizime, çfarë do të pranojmë. Ne jemi të përkushtuar ndaj Kosovës, ndaj sovranitetit dhe suksesit të saj ekonomik. Jemi plotësisht të vetëdijshëm për rolin historik që Shtetet e Bashkuara të Amerikës e kanë

### Thaçi: Dialogu duhet të mbyllet me njohje reciproke dhe anëtarësim të Kosovës në OKB

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se përfundimi i dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të përfundojë me anëtarësim të Kosovës në Kombet e Bashkuara dhe me njohje reciproke. Presidenti Thaçi ka thënë se opsionet e tjera në lidhje me përfundimin e dialogut janë të pakuptimta dhe false. "Fundi i dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, përfshirë edhe demarkimin e 400 kilometrave në mes të dy vendeve, duhet të përmbyllet me njohje reciproke dhe anëtarësim të Kosovës në OKB dhe organizata të tjera. Opinione të tjera rreth rezultateve të këtij dialogu janë të pakuptimta apo interpretime false", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Twitter".

## 9 000 maturantë do t'i nënshtrohen testit në afatin e dytë

Në këtë afat testit të maturës do t'i nënshtrohen rreth 9 000 maturantë, ndërsa për mbarëvajtjen e procesit të testimit do të angazhohen 600 administrues dhe 70 komisionarë (kryetarë të qendrave testuese). Pjesa e parë e testit të maturës do të organizohet më 28 gusht, kurse pjesa e dytë e testit më 1 shtator



**EPOKA E RE** Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 17 GUSHT - Komisioni Shtetëror i Maturës ka mbajtur të premten mbledhjen e radhës, në të cilën është diskutuar rreth përgatitjeve për afatin e dytë të Maturës Shtetërore 2018. Anëtarët e Këshillit Shtetëror të Maturës kanë miratuar edhe një

dokument me informacione të rëndësishme rreth afatit të gushtit. Në këtë afat, testit të maturës do t'i nënshtrohen rreth 9 000 maturantë, ndërsa për mbarëvajtjen e procesit të testimit do të angazhohen 600 administrues dhe 70 komisionarë (kryetarë të qendrave testuese).

Paraqitja e provimit të maturës

ka filluar dhe afati është i hapur deri më 24 gusht 2018. Po ashtu, edhe grumbullimi i shënimeve për nxënës, shkolla dhe komuna ka filluar dhe lista përfundimtare e administruesve dhe Qendrave Testuese do të

përfundojnë deri më 24 gusht 2018. Pjesa e parë e testit të maturës do të organizohet më 28 gusht, kurse pjesa e dytë e testit më 1 shtator, ndërsa publikimi i rezultateve do të bëhet më 10 shtator. Po ashtu,

Komisioni Shtetëror i Maturës ka bërë me dije se afati i ankesave do të jetë nga 11 deri më 13 shtator 2018, ndërsa rezultatet e ankesave do të bëhen të ditura një ditë më vonë, pra më 14 shtator 2018.

# Dëmet nga vërshimet në Therandë parashihen të jenë miliona euro



Kryetari i Komunës së Therandës, Bali Muharremaj, ka bërë me dije se dëmet nga vërshimet e fundit në këtë komunë parashihen të jenë miliona euro. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", në të cilën ka folur për pasojat e përmbytjeve nga reshjet e shiut, Muharremaj ka thënë se më të prekura janë rrugët, hapësirat bujqësore dhe katet përdhes të shtëpive. Përveç dëmeve materiale, ai ka treguar se lëndime kanë pësuar edhe dhjetë persona. Kryetari Muharremaj ka deklaruar se mundësitë e kësaj komune për t'u përballur me këto dëme janë të pakta. Prandaj, sipas tij, mbështetja e Qeverisë për Therandën është shumë e nevojshme

mbështetja e Qeverisë është e mirëseardhur. "Natyrisht se ne i kemi mundësitë e pakta. Në bazë të kompetencave dhe fondit të vogël ne jemi vënë në dispozicion, por natyrisht se na duhet patjetër ndihma e Qeverisë së Kosovës. Kemi marrë premtime që do ta na ndihmojnë dhe natyrisht këtë ndihmë e presim me padurim", ka thënë Muharremaj.

Ndër të tjera, në këtë intervistë ai ka treguar edhe për hapat që i ka marrë kjo komunë për t'u përballur me situatën emergjente dhe për t'u dalë në ndihmë qytetarëve. "Kemi krijuar hapësira për evakuim nëse mund të kemi sërish reshje. Po ashtu, edhe Dega e Kryqit të Kuq ka krijuar hapësirat e veta për të ndihmuar. Po ashtu, kemi krijuar edhe Shtabin Emergjent dhe komisionet për verifikimin e gjendjes aktuale në terren. Si rezultat i gjendjes së tanishme urgjente të shtunën dhe të dielën do të punojnë Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, Drejtoria e Urbanizmit, Drejtoria e Bujqësisë, Drejtoria e Shëndetësisë. Kjo vjen si rezultat i punës së vazhdueshme në terren për t'iu shërbyer qytetarëve", ka thënë Muharremaj.

**"Epoka e re":** Z. Muharremaj, si është gjendja në Komunën e Therandës pas vërshimeve të

fundit të shiut?

**Muharremaj:** Siç jeni të njoftuar, ne jemi përballur me vërshim të ujit si rezultat i reshjeve të shumta të shiut. Dëmet janë të mëdha. Janë dëmtuar rrugë, hapësira bujqësore, katet përdhes të shtëpive etj. Kam kërkuar ndihmë nga të gjitha institucionet dhe atë mbrëmje në ndihmë kanë ardhur zjarrfikësit nga Malisheva dhe Prizreni. Tani kemi ndihmë edhe nga Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe institucionet e tjera.

**"Epoka e re":** Në cilat fusha janë dëmet më të mëdha dhe cilat janë masat që i ka ndërmarrë komuna në këtë drejtim?

**Muharremaj:** Dëmet janë të mëdha dhe, sipas të dhënave të cilat ende po i mbledhim, dëmet arrijnë shifra milionëshe në infrastrukturë dhe amvisëri. Janë dëmtuar rrugë, hapësira bujqësore dhe katet përdhes të shtëpive. Kemi krijuar hapësira për evakuim nëse mund të kemi sërish reshje. Po ashtu, edhe Dega e Kryqit të Kuq ka krijuar hapësirat e veta për të ndihmuar. Po ashtu, kemi krijuar edhe Shtabin Emergjent dhe komisionet për verifikimin e gjendjes aktuale në terren. Si rezultat i gjendjes së tanishme urgjente të shtunën dhe të dielën do të punojnë Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë,

Drejtoria e Urbanizmit, Drejtoria e Bujqësisë, Drejtoria e Shëndetësisë. Kjo vjen si rezultat i punës së vazhdueshme në terren për t'iu shërbyer qytetarëve.

**"Epoka e re":** A ka njerëz të lënduar nga këto vërshime?

**Muharremaj:** Natën e parë është lënduar shefi i njësisë së zjarrfikësve në Suharekë, Vehbi Krasniqi, më pas janë paraqitur edhe nëntë të lënduar lehtas. Ne po e përcjellim situatën dhe jemi në gatishmëri përballë kësaj gjendje.

**"Epoka e re":** Përafërsisht deri në sa mijë euro shkojnë dëmet e shkaktuara nga këto vërshime?

**Muharremaj:** Ua theksova se dëmet parashihen të jenë me miliona euro. Të hënën ne si institucione komunale do të dalim me të dhëna zyrtare rreth kësaj situatë.

**"Epoka e re":** Mund t'i mbulojë komuna këto dëme me kapacitetet që ka?

**Muharremaj:** Natyrisht se ne i kemi mundësitë e pakta. Në bazë të kompetencave dhe fondit të vogël ne jemi vënë në dispozicion, por natyrisht se na duhet patjetër ndihma e Qeverisë së Kosovës. Kemi marrë premtime që do ta na ndihmojnë dhe natyrisht këtë ndihmë e presim me padurim.

**EPOKA  
ERE**

**Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 17 GUSHT** - Kryetari i Komunës së Therandës, Bali Muharremaj, ka treguar për dëmet që ka pësuar kjo komunë nga vërshimet e fundit të shiut. Ai ka deklaruar se dëmet e shkaktuara nga reshjet e shiut parashihen të jenë miliona euro. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Muharremaj ka bërë me dije të hënën se do të dilet më të dhënat zyrtare të dëmeve. "Dëmet parashihen të jenë miliona euro. Të hënën ne si institucione komunale do të dalim me të dhëna zyrtare rreth kësaj

situatë", ka thënë Muharremaj. Duke folur për pasojat e përmbytjeve, ai ka deklaruar se, përveç dëmeve materiale, lëndime kanë pësuar edhe dhjetë persona. "Dëmet janë të mëdha. Janë dëmtuar rrugë, hapësira bujqësore, katet përdhes të shtëpive etj. Kam kërkuar ndihmë nga të gjitha institucionet. Atë mbrëmje në ndihmë kanë ardhur zjarrfikësit nga Malisheva dhe Prizreni. Tani kemi ndihmë edhe nga Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe institucionet e tjera", është shprehur ai. I pari i Therandës ka bërë me dije se mundësitë e kësaj komune për t'u përballur me këto pasojat janë të pakta prandaj, sipas tij,

Flet për "Epokën e re", Abelard Tahiri

# Logjika e kërcënimit të ins



Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka thënë se është më shumë se kurrë i fokusuar për fuqizimin e shtetit ligjor. Duke folur për dorëheqjen e prokurorit Elez Blakaj, për të cilën thuhet se ka ardhur për shkak të kërcënimit, ministri Tahiri ka theksuar kjo çështje mbetet për t'u sqaruar dhe janë të tjera organe ato që konstatojnë nëse ka pasur kërcënime. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se është e papranueshme që zyrtarët e institucioneve që zbatojnë ligjin të kërcënohen nga kushdo qoftë. "Mesazhi që unë kam përçuar dhe që i qëndroj plotësisht është se askush nuk është mbi ligjin dhe askush nuk do të duhej dhe nuk mund të shpresojë se Republika e Kosovës dhe institucionet e saj do të bien pre e presionit, kërcënimit apo shantazhit", ka thënë Tahiri, duke shtuar se mekanizmat e rendit dhe të ligjit kanë nevojë për koordinim edhe më të mirë

**EPOKA E RE****Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 17 GUSHT -

**"Epoka e re":** Ministër, a keni qenë në dijeni se prokurori Elez Blakaj, ashtu siç është raportuar, ka qenë i kërcënuar, pasi ka qenë i caktuar në detyrë për hetimin e listave të veteranëve të UÇK-së. Cilat janë informatat tuaja për këtë rast?

**Tahiri:** Mandati im i ministrit të Drejtësisë dhe i institucioneve që zbatojnë ligjin është i ndarë dhe në këtë rrafsh unë nuk kam pasur informata as për rastin e dorëheqjes së prokurorit, as për asnjë çështje që u takon organeve të pavarura ligjzbatuese. Lajmin e kam kuptuar nga mediat, por nuk kam mundur të rri indiferent ndaj arsyeve që janë përmendur si shkak i dorëheqjes së prokurorit. Ne jemi më shumë se kurrë të fokusuar për fuqizimin e shtetit

ligjor dhe është absolutisht e papranueshme që zyrtarët e institucioneve që zbatojnë ligjin të kërcënohen nga kushdo qoftë. Natyrisht e tërë kjo çështje mbetet për t'u sqaruar dhe janë të tjera organe ato që konstatojnë nëse ka pasur kërcënime, por mesazhi që unë kam përçuar dhe që i qëndroj plotësisht është se askush nuk është mbi ligjin dhe askush nuk do të duhej dhe nuk mund të shpresojë se Republika e Kosovës dhe institucionet e saj do të bien pre e presionit, kërcënimit apo shantazhit. Qytetarët presin me të drejtë të kenë besim në punën e institucioneve të drejtësisë dhe ky besim për asnjë çast nuk mund të cenohet nga askush.

**"Epoka e re":** Ka pasur reagime të ndryshme për këtë rast edhe nga Ambasada Amerikane, opozita dhe shoqëria civile.

Ambasadori amerikan Greg Delawie tha se dorëheqja e prokurorit Blakaj është ditë e pikëlluar për drejtësinë.

**Tahiri:** Kemi hyrë në dekadën e dytë të shtetit tonë sovran dhe pa dyshim se në procesin e shtetndërtimit nuk kemi qenë të vetëm. Angazhimi ynë për konsolidimin e shtetit ligjor ka pasur mbështetjen e vazhdueshme të partnerëve tanë zhvillimor, veçmas Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Deklarata e ambasadorit Delawie me tërë simbolikën e saj ka qenë plotësisht me vend. Natyrisht se ambasadori Delawie në deklarimin e tij i është bashkangjitur shqetësimi të njëjtë që kam pasur edhe unë dhe shoqëria civile dhe çdo qytetar i Kosovës që pret funksionim të mirëfilltë të sistemit të drejtësisë. Pa marrë parasysh rrethanat dhe pa dashur të

# titucioneve ka perënduar

*regjime të ndryshme se sistemi i drejtësisë nuk është në nivel për shkak të, siç thuhet, ndërhyrjeve politike.*

**Tahiri:** Drejtësia është një prej shtyllave themelore të një shoqërie demokratike dhe natyrisht se si shtet i ri, në konsolidim e sipër, nuk mungojnë perceptimet se ka ndikime politike në sistemin e drejtësisë. Por, si ministër i Drejtësisë mund t'ju them me përgjegjësi të plotë se preokupimet tona ditore janë hartimi i politikave publike që fuqizojnë pavarësinë e plotë dhe sigurojnë përgjegjshmërinë e sistemit të drejtësisë, përtej çdo ndikimi politik. Pakoja e ligjeve të gjyqësorit në veçanti dhe agenda legislative që kam shtruar para vetes do t'ju japin dimension dhe fizionomi të re institucioneve të sistemit të drejtësisë ku jo vetëm që nuk ka vend, por është e pamundur çfarëdo lloji ndikimi mbi punën e pavarur të këtyre institucioneve. Përveç pavarësisë kushtetuese dhe ligjore, gjyqësorit dhe prokurorisë i kemi ofruar në masë të konsiderueshme edhe mbështetje financiare, duke rritur buxhetin dhe duke rritur numrin e profesionistëve të angazhuar në këtë fushë. Këto masa nuk janë aspak të rastësishme, por në funksion të fuqizimit të sundimit të ligjit dhe forcimit të sigurisë juridike të sistemit të drejtësisë. Jam shumë optimist se angazhimi ynë i përbashkët në muajt në vijim do ta mbyllë edhe kapitullin e perceptimeve për ndikime politike në drejtësi.

**"Epoka e re":** *Ministër, a do të duhej që prokurorët të jenë të përgjegjshëm edhe në rastet kur marrin kërcënime që ata ta kërkojnë mbrojtjen e shtetit, në mënyrë që një hetim kur e nisnin, ta çojnë deri në fund?*

**Tahiri:** Në asnjë lloj veprimtarie publike nuk ka të drejta pa detyrime dhe nuk ka autorizime pa përgjegjësi. Pa dyshim se bartësit e funksioneve shtetërore të rëndësishme, siç është funksioni i prokurorit apo gjyqtarit, kanë përgjegjësinë e tyre për administrimin efikas të drejtësisë dhe vendosjen e saj deri në fund, pavarësisht se kush është palë. Por, krahas kësaj përgjegjësie, institucionet duhet t'ju ofrojnë mbrojtjen e plotë nga çdo cenim i mundshëm. Në mesin e nismave ligjore që kam ndërmarrë trajtohen edhe pavarësia dhe pacenueshmëria e gjyqësorit dhe prokurorisë, por paralelisht me të edhe përgjegjësia dhe llogaridhënia e tyre. Pakoja e ligjeve të gjyqësorit si dhe procesi i rishikimit funksional të

sektorit të sundimit të ligjit, që veçse është në rrugë të mirë për të prodhuar rezultatet e para, do t'ju japin zgjidhje afatgjatë problemeve të kësaj natyre.

**"Epoka e re":** *Prej se e keni marrë detyrën e ministrit, sa keni arritur ta ktheni besimin e qytetarëve në institucionet e drejtësisë?*

**Tahiri:** Besimi i qytetarëve në sistemin e drejtësisë varet nga shumë faktorë, duke nisur nga natyra rregulluese e ligjeve e

deri te zbatimi i mirëfilltë i tyre. Qasja ime prej ministri të Drejtësisë prej fillimit ka qenë e orientuar për identifikimin dhe ekspozimin e çdo problemi që rëndon mbi sistemin e drejtësisë sepse e vetmja mënyrë se si ndërtohet një sistem i qëndrueshëm është duke u ballafaquar me problemet dhe duke i orientuar të njëjtat drejt zgjidhjes. Mund t'ju konfirmoj me përgjegjësi të plotë se politikën legislative që kam sponsoruar do të

mundësojnë një epokë të re për sistemin e drejtësisë dhe pa dyshim se efektet e tyre do ta rrisin besimin e qytetarëve në mënyrë të plotë dhe të qëndrueshme. Pres koordinim më të mirë të institucioneve të rendit dhe ligjit që këto ligje të gjejnë zbatim të mirëfilltë dhe që bashkërisht të kontribuojmë në konsolidimin e një drejtësie në të cilën kanë besim të parzervë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

## Kosnetti thotë se Kosova duhet t'i ketë Forcat e Armatosura për mbrojtje

**PRISHTINË, 17 GUSHT** - Si çdo shtet sovran, edhe Kosova ka të drejtë t'i ketë forcat e armatosura dhe për këtë Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të punojnë me autoritetet e Kosovës për krijimin e forcave mbrojtëse. Kështu ka thënë Philip Kosnett, kandidat për ambasador të ardhshëm i ShBA-së në Kosovë.

Kosnett është emëruar nga presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës ambasador i ardhshëm në Kosovë. Ai të enjten është paraqitur para Komitetit të Senatit për Marrëdhënie me Jashtë, ku u është përgjigjur pyetjeve të ndryshme të disa senatorëve. Pos të tjerash, ai ka folur edhe për çështjen e transformimit të Forcës së

Sigurisë së Kosovës në Forcë të Armatosur.

Ai ka thënë se edhe Kosova, sikurse çdo shtet tjetër, ka të drejtë ta ketë ushtrinë e vet. "Do të punoj në mënyrë që Kosova të ketë aftësi vetëmbrojtëse. Si çdo vend tjetër, edhe Kosova e ka të drejtën e vet sovranë t'ju ndërtojë forcat e armatosura për mbrojtjen e vet. Shtetet e Bashkuara mbështesin tranzicionin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në një ushtri ndërvepruese në NATO, me mandat mbrojtës të limituar. Kosova duhet të qëndrojë në bashkëpunim të ngushtë me ne dhe ta vazhdojë shtrirjen e saj dhe të flasë edhe me serbët e Kosovës, që të garantojë një tranzicion të suksesshëm. Nëse unë konfirmohem ambasador, do të

punoj me aleatët e NATO-s dhe Kosovën që t'ju krijoj Forcat e Armatosura të Kosovës që të jenë të afta, gjithëpërfshirëse dhe një forcë që ndikon në stabilitetin e rajonit", ka deklaruar Kosnett.

Ndërkaq gjatë paraqitjes në Komitetin e Senatit për Marrëdhënie me Jashtë, Kosnett është pyetur lidhur me spekulimet për mundësinë e mbështetjes nga Shtetet e Bashkuara për idenë e shkëmbimit të territoreve. "Qëndrimi ynë nuk ka ndryshuar. Ne mbështesim dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja mes dy vendeve. Mendojmë se ka rëndësi kritike që të dyja vendet të avancojnë për t'ju kapërcyer tensionet e vjetra", ka thënë Kosnett.



paragjykojmë nëse dorëheqja e prokurorit ka ardhur për arsye personale apo për shkak të kërcënimeve, vetë ideja se një prokuror mund të kërcënohet për shkak të punës që bën, është e papranueshme dhe nuk mund të tolerohet asnjëherë. Prandaj, mesazhi që është dërguar nga ambasadori Delawie, krerët e institucioneve tona dhe e gjithë shoqëria, ka qenë mesazhi i fuqishëm, se logjika e kërcënimit të institucioneve tona ka perënduar njëherë e përgjithmonë dhe, po ashtu, është një sinjal për ne që kemi përgjegjësi në këtë fushë, se mekanizmat e rendit dhe ligjit kanë nevojë për një koordinim më të mirë në mënyrë që sundimi i ligjit dhe pacenueshmëria e organeve që e zbatojnë atë të bëhet standard i palëkundshëm.

**"Epoka e re":** *Me këtë rast ka*

## Dita e parë e Kurban Bajramit, të martën

PRISHTINË, 17 GUSHT (ER) - Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK) ka njoftuar se dita e parë e festës së Kurban Bajramit do të festohet të martën, më 21 gusht. "Manifestimi qendror për territorin e Kosovës kushtuar kësaj feste do të mbahet në Xhaminë e Madhe në Prishtinë dhe nis në orën 5:10,

me faljen e namazit të sabahut nga hfz. Xhelal ef. Kaloshi, pas të cilit do të jetë ligjërata tematike kushtuar kësaj feste, të cilën do ta mbajë Bahri ef. Sejdiu ligjërues në Xhaminë e Madhe në Prishtinë. Namazi i Kurban Bajramit falet në orën 06:25 të cilit do t'i prijë hfz. Xhelal ef. Kaloshi, ndërsa hytben,

mesazhin e Kurban Bajramit, do ta mbajë kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, myftiu Naim ef. Tërnavë", ka njoftuar BIK-u.

Me rastin e festës së Kurban Bajramit, ditën e parë, më 21 gusht 2018, Kryesia e BIK-ut si tradicionalisht do të organizojë pritje përurimi në selinë e Kryesisë nga ora 9:00-12:00.



# Spitali i ri pediatrik me Kardiokirurgji, por pa staf mjekësor

PRISHTINË, 17 GUSHT - Spitali pediatrik brenda Qendrës Klinike Universitare të Kosovës tashmë ka filluar të ndërtohet. Ky spital është donacion i Emirateve të Bashkuara Arabe me vlerë 22 milionë euro. Thuhet se afati për ndërtimin komplet të këtij objekti do të zgjasë 22 muaj. Brenda këtij spitali parashihet të ketë edhe Kardiokirurgji të Fëmijëve. Një shërbim i tillë mungon në Kosovë. Në vend janë rreth 400 fëmijë në vit që lindin me anomali në zemër. Prej tyre, rreth 200 kanë nevojë për intervenim kirurgjik, shërbim të cilin u duhet ta marrin jashtë vendit. Por, Ramush Beiqi, kardiolog pediatër, i tha "Radios Evropa e Lirë" se Kosova nuk e ka asnjë kardiokirurg për fëmijë. Ai është skeptik se brenda këtij objekti do të mund të ofrohet një shërbim i tillë. Ai ka shtuar se po qe se është paraparë Kardiokirurgjia, tashmë kuadri mjekësor është dashur të jetë në trajnim në mënyrë që një shërbim i tillë të mund të ofrohet. "Staf për Kardiokirurgji të Fëmijëve nuk ka në Kosovë. Duhet të shkojnë në trajnime pasi kemi kardiokirurgë adutë, por duhet të shkojnë për avancim, pasi është lëmë specifike. Kosova nuk e ka asnjë kardiokirurg për fëmijë aktualisht", ka thënë Beiqi. Ndërsa drejtori i Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, Basri Sejdiu, ka thënë



se brenda spitalit, përpos shërbimeve të tjera, do të ketë edhe Kardiokirurgji për fëmijë, ku me përgatitjen e infrastrukturës së objektit do të ketë edhe përgatitje të stafit njëkohësisht. "Po, do të jetë edhe Kardiokirurgjia e fëmijëve, pasi e kemi Kardiokirurgjinë për të rritur dhe është duke funksionuar. Ka edhe staf dhe ka profile, por me përgatitje të infrastrukturës do të ketë paralelisht edhe përgatitje të stafit", është shprehur

Sejdiu. Ish-presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga dhe Maitha Al Shamsi, ministre e Shtetit nga Emiratet e Bashkuara Arabe, patën zyrtarizuar fillimin e planeve për ndërtimin e një qendre pediatrike kirurgjike në Prishtinë. Për ndërtimin e kësaj qendre kanë deklaruar se do të dhurohen 22 milionë euro. Ish-presidentja e Kosovës, Jahjaga, pati thënë se klinika parashikohet të hapet në verën e vitin

2017. Megjithatë, një gjë e tillë nuk ndodhi. Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka shpjeguar arsyet e vonesave për ndërtimin e spitalit pediatrik. "Do të ndërtohet një spital pediatrik, i cili do të jetë modern, i cili do të ketë pajisje moderne, rreth 100 shtretër, 10 mijë metra katrorë, donacion mbi 20 milionë euro dhe që është i nevojshëm. Kemi mbetur peng për arsye sepse nuk kemi mundur të zhvillojmë

plane të tjera, e në anën tjetër nuk ka filluar realizimi i projektit. Një punë shumë e madhe është përfunduar dhe tani pritet që puna ta marrë hovin e vet, të shihet edhe duke u nisur katet e ardhshme", ka thënë Ismaili. Derisa ky spital të ndërtohet, shumë fëmijë nga Kosova janë të detyruar të shkojnë në vende të tjera, kryesisht në Turqi dhe vende të Bashkimit Evropian, për të kryer operacione në zemër.

## Punimet në Merdare dhe Mutidovë afër përfundimit, ngecje në Bërnjak

PRISHTINË, 17 GUSHT (ER) - Ministri i Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, ka pritur të premten në takim udhëheqësin e Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve (UNOPS), Brendan Keirnan. Në këtë takim u diskutua ecuria e zhvillimit të punimeve të tri pikave të përbashkëta kufitare me Serbinë në Merdare, Mutidovë dhe Bërnjak, në kuadër të

Menaxhimit të Integruar të Kufirit. Me këtë rast u vlerësua se punët në pikën kufitare në Merdare dhe Mutidovë janë shumë afër përfundimit. Këto pika kufitare do të jenë moderne dhe me standarde evropiane, ku do t'iu mundësohet qytetarëve lëvizja e lirë. Të dy bashkëbiseduesit shprehën shqetësimin e tyre për ngecjen e punimeve në pikën kufitare të Bërnjakut.

Ministri i Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, është zotuar se këtë çështje do ta adresojë edhe në nivelin më të lartë, me qëllim që kjo pikë kufitare të modernizohet dhe të lehtësohet kalimi i qytetarëve dhe mallrave. Gjithashtu, në këtë takim u dakorduan që edhe në të ardhmen të vazhdohet bashkëpunimi mes MPB-së dhe UNOPS për projekte të tjera.



# Policia sulmohet me ngjyrë, arrestohen tetë aktivistë të Vetëvendosjes

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 17 GUSHT - Aktivistë të Lëvizjes Vetëvendosje të premtën kanë hedhur ngjyrë në hyrje të objektit kryesor të Policisë së Kosovës në Prishtinë në shenjë pakënaqësie ndaj policisë për "mosreagim të policisë në dhunën

ndaj grave". Gjatë këtij aksioni janë arrestuar tetë aktivistë, duke përfshirë edhe deputeten Saranda Bogujevci, e cila është liruar gjatë ditës së premtë.

Arrestimi ka ndodhur për shkak se aktivistët e Vetëvendosjes i kanë gjuajtur me ngjyrë edhe policët. "Tetë aktivistë dhe aktivistë janë arrestuar gjatë aksionit simbolik të

organizuar kundër dhunës ndaj grave. Aktivistët e Lëvizjes kanë hedhur ngjyrë të kuqe në drejtim të Policisë së Kosovës pikërisht për shkak se kjo polici pranon çdo ditë raportime për dhunë dhe nuk bën asgjë, qëndron duarkryq e impotente përballë dhunës. Kjo polici i ka duart me gjakun e grave. Jo vetëm se shteti i Kosovës ka hequr

dorë dhe i ka braktisur gratë në pozitë të pabarabartë, por edhe Policia e Kosovës nuk duron të kërkohet drejtësi për to. Prandaj sot u arrestuan: Saranda Bogujevci, Rinë Zhitia, Arta Berisha, Elona Kurti, Diellëz Arifi, Patrik Domi, Çlirim Gërbeshi, Atthe Arifi", ka njoftuar Lëvizja Vetëvendosje.

Ndaj arrestimit të këtyre aktivisteve ka reaguar deputetja e Vetëvendosjes, Albulena Haxhiu. Ajo ka thënë se arrestimi i aktivistëve dhe deputetes Bogujevci është i papranueshëm. Policia e Kosovës ka bërë me dije se dhjetëra zyrtarë policorë kanë marrë lëndime gjatë kësaj proteste.

## Skënder Çeku dha kontribut të jashtëzakonshëm në forcimin e UÇK-së


PRISHTINË, 17 GUSHT (ER) - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, me rastin e 20-vjetorit të rënies heroike të gjeneralmajor Skënder Çekut, ka thënë se ai ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm për lëvizjen kombëtare dhe forcimin e bazave të UÇK-së. "Njëzet vjet më parë ndërroi jetë një nga luftëtarët më të devotshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Skënder Çeku. Ai ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në lëvizjen kombëtare, për forcimin e bazave të UÇK-së dhe drejtpërdrejt në fronte dhe beteja në vitin 1998. Skënder Çeku është ndër figurat më të ndritura që prodhoi lëvizja jonë kombëtare për liri dhe pavarësi të Kosovës", ka shkruar Thaçi në llog-

### Grabovci e Hadërgjonaj nderojnë gjeneral Skënder Çekun

Anëtari i Kryesisë së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Adem Grabovci, dhe deputetja e kësaj partie, Safete Hadërgjonaj, kanë bërë të premtën homazhe te varri i gjeneral Skënder Çekut me rastin e 20-vjetorit të rënies së tij heroike.

arinë e vet në "Facebook". Edhe kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka përkujtuar gjeneralmajor Skënder Çekun. Haradinaj ka thënë se gjeneral Çeku është bërë gurthemel i shtetit të Kosovës. "Me pietet të lartë kujtojmë sot 20-vjetorin e rënies heroike të gjeneralmajor Skënder Çekut. Beteja e Loxhës shënon një nga

ngjarjet kulmore të historisë sonë të re. Gjeneral Çeku ishte një nga luftëtarët më të shquar në rrugën tonë për liri dhe flijimi i tij dhe luftëtarëve të tjerë u bënë gurthemele të shtetit të Kosovës. Porosia e tyre, frymëzim i përjetshëm për brezat!", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook". Edhe zëvendëskryeministri Fatmir



Limaj ka përkujtuar heroin Skënder Çeku. Limaj ka thënë se si luftëtar i paepur i çështjes kombëtare, Skënder Çeku ishte shembulli më i mirë se si i dilet zot vendit. "Vepra e Skënder Çekut ishte dhe do të

mbetet burim frymëzimi edhe për brezat e ardhshëm. Kosova do t'i nderojë përjetë dëshmorët dhe martirët e rënë të cilët janë themele të lirisë sonë", ka thënë Limaj.



## Vazhdon vendosja e pengesave në rrugët e Rahovecit

RAHOVEC, 17 GUSHT - Komuna e Rahovecit, përkatësisht Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria për Punë

Inspektuese, ka vazhduar realizimin e projektit për shenjzimin horizontal të rrugëve (pengesave rrugore) të rrugëve në

qendër të qytetit. Për këtë projekt ka folur drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Përparim Krasniqi, i cili ka thënë

se punimet në kuadër të projektit shenjzimi horizontal i rrugëve (pengesave rrugore) është duke shkuar sipas planit.



# 'Adem Jashari' zvogëlon nivelin e karbonit të emetuar për 23 për qind

**EPOKA  
ERE****A. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 27 GUSHT** - Zhvillimi i praktikave të mira mjedisore me qëllim të mbrojtjes së ambientit mbetet një ndër sfidat më të vështira në industrinë e avionit. Duke qenë të vetëdijshëm për impaktin e korporatave në

mjedisin ku operojnë, kompania "Limak" që menaxhon ANP "Adem Jashari" tashmë për disa vjet është duke implementuar programe menaxhuese që kanë ndikuar në zvogëlimin e emetimit të dyoksidit të karbonit. Për më tepër, ANP "Adem Jashari" ka thelluar bashkëpunimin me partnerët e tjerë duke i nxitur

jenë pjesë e këtyre programeve në mënyrë që të gjithë së bashku të kontribuojnë për një mjedis sa më të pastër.

Si rezultat, Akreditimi i Karbonit në Aeroporte ka akredituar ANP "Adem Jashari" në nivelin e tretë (Optimizimi) për menaxhimin e suksesshëm të gazrave serë. Me anë të këtyre politikave të favor-

shme mjedisore është arritur që niveli i karbonit për udhëtar të ulët për 23 për qind (tonCO<sub>2</sub>/udhëtar), ndërkaq në total është arritur të reduktohet për 6 për qind (tonCO<sub>2</sub>).

Ngritja e ANP "Adem Jashari" në nivelin e tretë të këtij programi e vendos atë në mesin e 19 aeroporteve anëtare nga 10 vende të

ndryshme të Evropës.

Akreditimi i Karbonit në Aeroporte është program i cili administrohet nga kompania ndërkombëtare këshilluese WSP Parsons Brinckerhoff, e caktuar nga Këshilli Ndërkombëtar i Aeroporteve në Evropë, i cili përfaqëson rreth 500 aeroporte nga 45 vende evropiane.

## Transportuesit rrugorë të regjionit të Prizrenit ndërpresin grevën

**PRISHTINË, 17 GUSHT (ER)** - Në emër të ministrit të Infrastrukturës, Pal Lekaj, këshilltari politik i tij, Pjeter Ndou, bashkë me drejtorin e Departamentit të Transportit, Xhemë Veseli, kanë pritur të premtën në takim kryetarin e Shoqatës së Transportuesve Rrugorë të Kosovës, njëherësh anëtar i kryesisë së Odës Ekonomike të Kosovës, Ruzhdi Kurtishi, dhe përfaqësues të Shoqatës së Transportuesve nga regjioni i Prizrenit.

Ndou dhe Veseli dëgjuan ankesat dhe kërkesat e shoqatës, të cilat i shtyn për të hyrë në grevë dhe pas diskutimeve konstruktive, të dyja

palët ranë dakord të ndërpritet greva dhe të vazhdohet operimi normal i linjave të rregullta, Prizren - Prishtinë dhe anasjelltas. Ndou ka theksuar përkushtimin maksimal të ministrit Lekaj dhe të kabinetit për zgjidhjen e të gjitha problemeve të operatorëve ekonomikë, gjithmonë në dobi të shërbimit të qytetarëve.

Ministria e Infrastrukturës, gjegjësisht Departamenti i Transportit Rrugor, në bashkëpunim me operatorë, shoqatat dhe të tjera palë relevante, në afat sa më urgjent do t'i trajtojnë dhe zgjidhin të gjitha problemet që i kanë transportuesit.



## Bëhet ekzekutimi i pagesave për skemat sociale dhe pensionet

**PRISHTINË, 17 GUSHT (ER)** - Ministria e Financave ka bërë të premtën ekzekutimin e pagesave për muajin gusht të skemave sociale dhe të pensioneve. Për nder të fes-

tës së Bajramit të Vogël - Kurban Bajramit, ekzekutimi i pagesave është bërë disa ditë më herët nga ekzekutimi i rregullt. Me këtë rast, ministri i Financave, Bedri

Hamza, të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës ua uron festën e Bajramit të Vogël, duke u dëshiruar shëndet, mbarësi dhe gjithë të mirat.



## Aktakuzë ndaj Agron Mustafës, Ejup Qerimit dhe Rexhë Gjonbalajt

PRISHTINË, 17 GUSHT - Prokuroria Speciale e Kosovës ka ngritur aktakuzë kundër tre ish-zyrtarëve të lartë të Telekomit të Kosovës. Të gjithë ata akuzohen për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar, thuhet në një komunikatë të Prokurorisë Speciale të Kosovës. Sipas aktakuzës, i pandehuri Ejup Qerimi, ish-menaxher i Telekomit, gjatë periudhës kohore shkurt 2012, tetor 2014, duke shfrytëzuar detyrën, respektivisht autoritetin zyrtar, nuk i ka përmbushur detyrat e veta zyrtare, me qëllim që t'i shkaktojë dëme materiale dikujt tjetër. Me këto veprime i pandehuri ka kryer veprën penale, "keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar".

Ndërkaq i pandehuri Agron Mustafa, po ashtu ish-menaxher i Telekomit, nga data 19. 2. 2015, kur ka marrë pozitën

udhëheqëse e deri më datën 24. 5. 2017, kur ky i pandehur, edhe pse nuk ka qenë kompetent, kishte lidhur marrëveshje për ekzekutimin e vendimit final, duke shfrytëzuar detyrën, respektivisht autoritetin zyrtar nuk i ka përmbushur detyrat zyrtare, me qëllim që t'i shkaktojë dëme materiale një kompanie tjetër.

Po ashtu, në aktakuzën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës theksohet se "i pandehuri i tretë, Rexhë Gjonbalaj, ish-kryetar i Bordit të Telekomit, duke shfrytëzuar detyrën e tij zyrtare, nuk e ka përmbushur detyrën e vet zyrtare me qëllim që t'i shkaktojë dëme materiale dikujt tjetër. Me këto veprime, i pandehuri Gjonbalaj ka kryer veprën penale, "keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar", thuhet në komunikatën e Prokurorisë.



## Në nëntor mbahet Forumi Ekonomik Kosovë - Greqi



PRISHTINË, 17 GUSHT (ER) - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi, ka pritur në takim zëvendësministren e Punëve të Jashtme, Rejhan Vuniqi, dhe drejtorin e Departamentit për Diplomaci Ekonomike, Guner Ureya.

Gjatë këtij takimi është biseduar për rëndësinë e bashkëpunimit të vazhdueshëm në mes të dyja palëve në kuadër të zhvillimit të diplomacisë ekonomike të vendit dhe për nxitjen e investimeve të huaja

në Kosovë.

Po në këtë takim është biseduar edhe për organizimin e forumeve ekonomike që kanë për qëllim ngritjen dhe zgjerimin e mëtutjeshëm të marrëdhënieve nga sektori ekonomik me vendet që nuk e kanë njohur ende shtetin e Kosovës.

Një prej tyre është Forumi Ekonomik që do të organizohet në nëntor në Athinë në mes të Kosovës dhe Greqisë, në të cilin do të jenë pjesëmarrës ndërmarësit nga të dyja vendet.

## Ministria e Infrastrukturës ndan mbi një milion euro për projektet rrugore të Lipjanit

PRISHTINË, 17 GUSHT (ER) - Ministria e Infrastrukturës, e përfaqësuar nga zëvendësministri Rexhep Kadriu me bashkëpunëtorë, të premtan vizituan Lipjanin për t'u takuar me të parin e kësaj komune, Imri Ahmetin. Përfaqësuesit e dy institucioneve në fjalë nënshkruan memorandum bashkëpunimi për vitin 2018 dhe anekset e marrëveshjeve paraprake për disa projekte rrugore në Lipjan, që arrijnë shifrën 1,203,468 euro. Nga memorandum do të financohet rruga përgjatë hekurudhës Glllogovc - Rubovc, ndërsa mjetet e tjera janë ndarë për vazhdimin e projekteve për rrugët Magurë-Blinaj, Vojnovc-Topljan dhe Llugaxhi-

Gadime.

Duke ndarë përgjegjësitë për dinamizimin dhe përshejtimin e projekteve infrastrukturore, kryesisht asfaltimin e rrugëve të Lipjanit, zëvendësministri Kadriu ka thënë se Ministria e Infrastrukturës do të jetë e gatshme që në çdo kohë të ofrojë përkrahje dhe të shërbejë në të mirë të qytetarëve të Lipjanit.

Kadriu nën shoqërinë e Ahmetit vizitoi edhe udhëkryqin e Janjevës, në magjistralen Prishtinë - Ferizaj (N2), për të cilin paralajmëroi rinisje të shpejtë të punimeve për ndërtimin e një rrethrotullimi që, sipas kryetarit të Lipjanit, është i nevojshëm. Shumë



## Komuna e Malishevës vazhdon dëgjimet publike për hartimin e buxhetit



**MALISHEVË, 17 GUSHT (ER)** - Në kuadër të hartimit të buxhetit për vitin 2019 dhe me qëllim të orientimit në investimet kapitale për vitin e ardhshëm, Komuna e Malishevës është duke zhvilluar dëgjime publike me qytetarë. Përmes këtyre dëgjimeve do të hartohet edhe lista e projekteve kapitale dhe investimet do të orientohen duke u bazuar në kërkesat dhe nevojat e qytetarëve. Për këtë qëllim një takim i tillë është mbajtur me banorët e fshatit Bellanicë. Në këtë takim ka marrë pjesë edhe kryetari i Malishevës, Ragip Begaj, me bashkëpunëtorë, të cilët kanë prezantuar para banorëve të këtij fshati buxhetin për vitin 2019, në veçanti pjesën e investimeve kapitale.

Begaj në fjalën e tij ka thënë se buxheti i Komunës së Malishevës do të orientohet sipas kërkesave të qytetarëve të kësaj komune. "Marrja e kërkesave dhe nevojave të juaja

si banorë është qëllimi i këtij takimi, ku përmes propozimeve tuaja ne e kemi më të lehtë orientimin e hartimit të buxhetit, përkatësisht orientimin në investimet për vitin e ardhshëm, pasi ju e dini më së miri se cilat janë nevojat e juaja dhe pasi t'i marrim propozimet nga ju, do ta hartojmë listën e investimeve dhe do ta paraqesim para kuvendit për miratimin përfundimtar", ka thënë Begaj. Ndërsa drejtori për Buxhet dhe Financa, Valon Mazreku, ka prezantuar buxhetin për vitin 2019 dhe ka bërë me dije se për investime kapitale, Malisheva do të ketë një buxhet prej 4.3 milionë eurosh, ndërsa lista e investimeve do të përpilohet gjithmonë duke u bazuar në kërkesat dhe nevojat e qytetarëve. Më pas banorët e fshatit Bellanicë, duke i prezantuar kërkesat e tyre, kanë kërkuar të vazhdohet investimet në rregullimin e infrastrukturës, duke përfshirë rrugët, kanalizimin e fshatit, trotualet, ndriçimin, si dhe mirëmbajtjen e ujësjellësit. Po ashtu, ata kanë kërkuar të investohet edhe në fushën e bujqësisë dhe në sinjalizimin e rrugëve.



## Vazhdon situata emergjente në Suharekë, Muharremaj kërkon ndihmë

**SUHAREKË, 17 GUSHT (ER)** - Komuna e Suharekës është përballur me vërshime të cilat kanë shkaktuar dëme materiale. Po ashtu, si pasojë e këtyre vërshimeve janë lënduar edhe disa persona. Kryetari i Suharekës, Bali Muharremaj, ka thënë se situata në këtë komunë është emergjente. Në këtë kontekst, ai

ka kërkuar përkrahje nga të gjithë për t'u dalë në ndihmë atyre që janë prekur nga vërshimet. "Situata emergjente në Komunën e Suharekës vazhdon. Apeloj tek të gjitha bizneset, organizatat humanitare dhe institucionet e tjera të ndihmojnë me veshmbathje, ushqim, ujë të pijes etj. Këto mund t'i dorëzo-

jnë te Kryqi i Kuq në Suharekë", ka deklaruar Muharremaj. Ai ka thënë se tani duhet të punojnë për pastrimin e qytetit i cili është në gjendje të keqe si pasojë e vërshimeve. "Të gjitha ekipet janë në terren për pastrimin e rrugëve dhe për t'u dhënë ndihmë qytetarëve", ka deklaruar Muharremaj.



## AShNA ndihmon kryeqytetin me të dhëna meteorologjike

**PRISHTINË, 17 GUSHT (ER)** - Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (AShNA) dhe kryeqyteti i Kosovës Prishtina, kanë nënshkruar marrëveshje mirëkuptimi në lidhje me ofrimin e të dhënave meteorologjike për këtë të fundit.

Palët përmes kësaj marrëveshjeje u pajtuan që në vazhden e përp-

jekjeve për adresimin e ndotjes së ajrit në Prishtinë, Departamenti Meteorologjik i AShNA-së do t'i dërgojë Drejtorisë së Administratës së Prishtinës të dhënat meteorologjike në baza të rregullta kohore.

Nga këto të dhëna kryeqyteti do të përfitojë përmes njoftimit të

publikut se kur pritet të ketë stagnim të lëvizjes së masave ajrore, rrjedhimisht rritje të ndotjes së ajrit në Prishtinë. Marrëveshja u nënshkrua nga menaxheri i Departamentit Meteorologjik në AShNA, Sherif Gosalci dhe nënkryetari, njëherësh drejtor i Drejtorisë së Administratës së Prishtinës, Muhedin Nushi.

## Inaugurohet Akademia e Edukimit 'Hello' në Gjiilan

**GJILAN, 17 GUSHT (ER)** - Në Komunën e Gjiilanit është inauguruar objekti i ri i Akademisë së Edukimit "Hello". Kryetari i kësaj komune, Lutfi Haziri, së bashku me pronarin e kësaj akademie, Florian Kurteshi, pasi kanë prerë shiritin e objektit të ri, kanë përgëzuar për suksesin e jashtëzakonshëm për krijimin e kushteve evropiane për edukim cilësor. "Kjo qendër për një kohë shumë të shkurtër ka arritur të dëshmojë sukses jashtëzakonisht të madh dhe jorastësisht në Ditën e Çlirimit të Gjiilanit e kemi shpërblyer me mirënjohje. Urime pronarëve, fëmijëve dhe

prindërve për këtë objekt me kushte evropiane për edukim!", ka thënë Haziri.

Kryetari i Haziri ka shfaqur besimin se nga kjo shkollë do të dalin nxënës me përgatitje të lartë, të cilët në të ardhmen do të profilizohen për t'i shërbyer Gjiilanit dhe Kosovës në shumë fusha të shkencës. Ndërsa drejtori i Akademisë së Edukimit "Hello", Florian Kurteshi, ka bërë me dije se objekti i ri ka 5 400 metra katrorë hapësirë të brendshme dhe 7 500 metra katrorë oborr, duke u mundësuar fëmijëve të ciklit fillor dhe atij parashkollor kushte evropiane për nxënien e dijes.



# FANTAZMAT E NDARJES PO BEZDISIN BALLKANIN KËTË VERË



**Nga Janusz BUGAJSKI**

Pas disa deklaratave provokuese nga politikanët serbë dhe kosovarë, dhe në mes të heshtjes relative nga Uashingtoni dhe Brukseli, po shtohen supozimet se po planifikohet një plan territorial midis Beogradit dhe Prishtinës.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka pohuar se dialogu Beograd - Prishtinë do të përfshijë bisedime mbi "korrigjimet kufitare" - një term që nënkupton shkëmbimin e territoreve dhe jo thjesht marrëveshjet e demarkacionit. Disa zyrtarë serbë kanë paraqitur në mënyrë të përsëritur mundësinë territoriale për t'i normalizuar marrëdhëniet mes dy shteteve, por deri më tani çështja nuk është marrë seriozisht.

Thaçi deklaroi se bisedimet me Beogradin duhet ta konsiderojnë bashkimin me Kosovën të Luginës së Preshevës, një pjesë e Serbisë jugore me popullsi shumicë shqiptare. Thaçi qartazi dëshiron ta sjellë Preshevën në diskutim dhe të mos përballet me dorëzimin e njëanshëm të

veriu të Kosovës, në të cilin serbët formojnë shumicën në katër komuna.

Shtetet e Bashkuara dhe BE-ja kanë kundërshtuar vazhdimisht çdo ndryshim kufitar, duke parë lëvizje të tilla si të rrezikshme në një rajon ende të paqëndrueshëm. Por, thashethemet tani po tregojnë se Uashingtoni dhe Brukseli mund të kërkojnë për ta zgjidhur mosmarrëveshjen Serbi - Kosovë me një opsion territorial.

Në deklaratat e mediave, ambasadori i ShBA-së në Kosovë dhe zëdhënësi i Komisionit Evropian nuk përjashtuan rishikimet territoriale, thjesht duke pohuar se Beogradi dhe Prishtina kishin nevojë të arrinin një zgjidhje. Në të njëjtën kohë, ministri i Jashtëm i Serbisë, Ivica Dačić, pohoi se ai kishte diskutuar një ndarje të mundshme gjatë një vizite në Uashington. Vetëm kancelarja gjermane Angela Merkel haptas hodhi poshtë çdo ndryshim kufitar gjatë një takimi të fundit në Berlin me kryeministrin boshnjak.

Historikisht, ndarjet nuk janë asgjë e re, qoftë përmes përshatjeve të pasluftës nga partitë fitimtare, ose në bazë të plebishiteve demokratike apo marrëveshjeve ndërqeveritare. Ndërsa Jugosllavia u shpërbë nëpër luftëra dhe zgjedhje, Moska nuk ishte në gjendje ta

mbante Bashkimin Sovjetik me forcë dhe Çekosllovakia u nda në mënyrë miqësore nga Praga dhe Bratislava. Sidoqoftë, në çdo rast, vendet e reja ishin ish-subjekte federale që kishin kufijtë e qartë administrativë dhe qeveritë e zgjedhura. Ndarja e mundshme e Kosovës do të legjitimonte një parim të rindarjes së shteteve që dolën nga federatat e pushuara komuniste.

Një proces i tillë do të kërkonte të paktën katër kushte të realizoheshin në mënyrë paqësore. Së pari, sepse vetëm shtetet sovraane mund ta shkëmbejnë territorin, Serbia dhe Kosova duhet ta njohin njëra-tjetrën si vende të pavarura dhe të mos bllokojnë hyrjen në institucionet ndërkombëtare. Së dyti, miratimi popullor në të dy vendet duhet të sigurohet qoftë nëpërmjet parlamentit ose një referendumi publik. Së treti, ndërjetësimi ndërkombëtar do të ishte thelbësor për të zbatuar ndonjë marrëveshje territoriale. Dhe, së katërti, qytetarët e prekur nga shkëmbimet e tokës do të duhej të ndihmoheshin në zhvendosjen në shtetin e zgjedhur prej tyre.

Por edhe nëse të gjitha këto kushte plotësohen, ndryshimet kufitare në Ballkanin Perëndimor janë të mbushura me rreziqe dhe do të interpretohen në të gjithë rajonin si legjitimimi i homogenizimit

kombëtar. Me parimin e multietnicitetit, që dukshëm po ikte, kërkesat për monoetnicitet do të përshkallëzonin dhe potencialisht do të zbulonin disa vende. Institucionet perëndimore dhe forcat e NATO-s mund të gjejnë veten të papërgatitur për valën e paqëndrueshmërisë që më pas mund ta përfshijë rajonin.

Në Kosovë vetë Kisha Ortodokse Serbe kundërshton me forcë çdo humbje të territorit, veçanërisht pasi shumica e vendeve fetare serbe dhe mbi 60 % e popullsisë serbe nuk janë të vendosura në komunat veriore. Serbët dhe shqiptarët e radikalizuar mund të nxisin protesta të dhunshme për ta dëbuar etninë tjetër nga territoret e tyre të caktuara. Dhe një proces i ngjashëm mund të parashikohet në luginën e Preshevës nëse është dakord një shkëmbim tokash.

Rishikimet territoriale gjithashtu do ta rrisin mbështetjen në Kosovë për bashkim me Shqipërinë. Një moment i tillë mund të përhapet me shpejtësi në Maqedoni ku të paktën një e katërta e popullsisë është shqiptare. Kërcënimet ndaj integritetit territorial të Maqedonisë do ta intensifikonin etnonacionalizmin, potencialisht do ta shkatërronin marrëveshjen e emrit me Greqinë dhe do ta sillnin Bullgarinë dhe Shqipërinë në një konflikt në zgjerim.

Ndërkohë, njësia serbe në Bosnje Hercegovinë mund ta kërkonte zbatimin e precedentit të Kosovës për t'u bashkuar me Serbinë; popullata kroate mund të kërkojë që Hercegovina perëndimore të absorbohet nga Kroacia; dhe popullata boshnjake mund të bënte fushatë për rajonin me shumicë myslimane të Serbisë në Sandjak për t'u bashkuar me Bosnjën. Mali i Zi, gjithashtu, do të kapet në mes të këtij maelstromi, me boshnjakët, serbët dhe shqiptarët. Dhe e gjithë kjo nuk ka gjasa të ndodhë në një klimë paqësore politike dhe politike, por mund të jetë e mbushur me incidente të dhunshme për të provuar se ndarja ishte e nevojshme.

Edhe pse një skenar i tillë duket si një shpërblim ballkanik për Kremlinin dhe mund të kontribuojë në justifikimin e ndarjes së saj të Ukrainës, Gjeorgjisë dhe Moldavisë, do të ishte e parakohshme që Moska ta festonte ndarjen e çdo shteti ballkanik. Zhvillime të tilla do të nënvizonin se vetë Federata Ruse, që përmban 85 njësi federale, mund të ndahet në mënyrë territoriale sipas parimeve etnike, fetare ose rajonale. Paradoksalisht, ndarja e Kosovës apo e Bosnjës mund të shërbejë si një prototip për shpërbërjen e ardhshme të Rusisë.

*(Marrë nga www.cepa.org)*

## INTENSITET I SHTUAR I PUNIMEVE NË SHKOLLËN 'ELENA GJIKA'

Objekti i shkollës "Elena Gjika" është objekt i trashëgimisë kulturore dhe si rrjedhojë do të ruhet fasada. 18 klasë të shkollës fillore dhe tri klasë të parashkollorëve do të rinovohen në tërësi, kurse në 10 klasat e tjera që janë rinovuar para pak viteve do të intervenohet vetëm në pjesët e dëmtuara.

**PRISHTINË, 17 GUSHT (ER)** - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, bashkë me koordinatoren e TIKA-s për Kosovë, Hasan Burak Ceran, kanë vizituar të premtën shkollën "Elena Gjika" për ta parë ecurinë e punimeve që po zhvillohen brenda objektit.

Objekti i shkollës "Elena Gjika" është objekt i trashëgimisë kulturore dhe si rrjedhojë do të ruhet fasada. 18 klasë të skol-

lës fillore dhe tri klasë të parashkollorëve do të rinovohen në tërësi, kurse në 10 klasat e tjera që janë rinovuar para pak viteve do të intervenohet vetëm në pjesët e dëmtuara.

Gjithashtu, do të vendoset i gjithë inventari i ri si dhe do të rregullohet oborri i shkollës. Intensiteti i shtuar i punimeve na siguron që qysh në fillimin e vitit të ri shkollor objekti të jetë i gatshëm për nxënësit dhe stafin e kësaj shkolle.



## Trumpi anulon paradën ushtarake të nëntorit

Uashington, 17 gusht - Presidenti amerikan Donald Trump njoftoi të premten se e anuloi paradën ushtarake të planifikuar për në nëntor për

shkak të kostos së lartë dhe njoftoi se në vend të saj do të shkojë në Paris për të marrë pjesë në ceremonitë në kujtim të përfundimit të Luftës së Parë

Botërore. Presidenti e kërkoi zhvillimin e paradës për t'i nderuar trupat amerikane me rastin e 100-vjetorit të Luftës së Parë Botërore, pasi u kthye nga

ceremonitë me rastin e festës kombëtare të Francës ku mori pjesë vitin e kaluar. Por të enjten, zyrtarët thanë se kostoja e një parade të tillë



Kancelarja e Gjermanisë, Angela Merkel, ka takuar kryeministrin malazias Dushko Markoviq

## Berlini dhe Podgorica pajtohen për mosndryshim të kufijve në Ballkan

Gjatë takimit të kancelares gjermane Angela Merkel me kryeministrin malazias Dushko Markoviq është theksuar se të dyja palët shprehën mendimet se nuk mund të ketë ndryshim të kufijve të Ballkanit. "Mali i Zi dhe Gjermania janë tërësisht dakord që nuk ka ndryshime të kufijve në Ballkan", kanë theksuar Merkel dhe Markoviq



Vlada Crne Gore @VladaCG · 5h

Premijer Duško Marković i kancelarka Angela Merkel - #CrnaGora i #Njemačka potpuno saglasne: nema promjena granica na Balkanu



BERLIN, 17 GUSHT - Kryeministri i Malit të Zi, Dushko Markoviq, ka zhvilluar të premten një takim me kancelaren gjermane Angela Merkel në Berlin, ku është diskutuar edhe mbi situatën në Ballkan. Në një postim të publikuar në faqen zyrtare në "Twitter" të Qeverisë së Malit të Zi theksohet se të dyja palët shprehën mendimet se nuk mund të ketë ndryshim të kufijve të Ballkanit. "Mali i Zi dhe Gjermania janë tërësisht dakord që nuk ka ndryshime të kufijve në Ballkan", kanë theksuar Merkel dhe Markoviq. Deklarata vjen në kohën kur në opinionin e Kosovës dhe Serbisë po debatohet intensivisht për

ndryshimin e kufijve mes dy vendeve. Kjo është vizita e parë e kryeministrit Markoviq në Gjermani që u zhvillua në kuadër të Procesit të Berlinit dhe të integriteteve evropiane të Malit të Zi.

Kancelarja gjermane Angela Merkel ka folur edhe për takimin që pritet ta zhvillojë me presidentin rus Vladimir Putin. Ajo ka thënë se do të ketë bisedime të komplikuar për Sirinë dhe kryesisht Ukrainën me presidentin Putin, i cili do ta vizitojë sot (e shtunë) Gjermaninë. "Do të ketë kundërvënje dhe, sigurisht, do të ketë pika mbi të cilat ne mund të reflektojmë në mënyrë që të mund ta nxisim

dhe përmirësojmë bashkëpunimin tonë dypalësh apo ndërkombëtar", deklaroi të premten kancelarja gjermane Merkel gjatë një konference në Berlin me rastin e vizitës së kryeministrit malazias, Dushko Markoviq. "Numri i problemeve që na shqetësojnë, nga Ukraina

te Siria, duke kaluar nga çështja e bashkëpunimit, përfshirë edhe bashkëpunimin ekonomik, është aq i lartë saqë është e justifikuar të jemi në dialog të vazhduar", tha ajo. "Asnjë rezultat në veçanti nuk pritet nga takimi i së shtunës", tha kancelarja gjermane.

Gjermania dhe Franca janë mbikëqyrëset e procesit të paqes në Ukrainë që sot duket në një pikë të vdekur. Rusia akuzohet nga Kievi dhe perëndimorët se po mbështesin ushtarakisht separatistët në Lindje të Ukrainës, që ajo e mohan.

## Pentagoni: Ushtria kineze mund të jetë trajnuar për sulme drejt ShBA-së

WASHINGTON, 17 GUSHT - Ushtria e Kinës ka zgjeruar operacionet bombarduese në vitet e fundit dhe se të njëjtat ka mundësi të kenë pasur qëllim trajnimin për sulme kundër Shteteve të Bashkuara dhe aleatëve të saj, është thënë në një raport të publikuar nga Pentagoni të enjten, transmeton "Reuters".

Ky raport, që vjen në kohën e tensioneve të larta ShBA - Kinë, për shkak të çështjeve tregtare, ka treguar përpjekjet e Kinës për ta rritur ndikimin në botë me shpenzime ushtarake, të cilat, sipas Pentagonit, kanë kaluar



shifrën e 190 miliardë dollarëve amerikanë më 2017. Një vlerësim i tillë është bërë

tekta të dy vendet planifikojnë të zhvillojnë negociata për tregti, duke synuar ta zgjidhin

konfliktin e përshkallëzuar për tarifa, që rrezikon të kthehet në luftë tregtare. Këtë vit forcat

ajrore të Kinës kanë ulur disa bombardues në ishujt e rajonit të diskutueshëm të Detit të Kinës Jugore në kuadër të stërvitjeve ushtarake.

Në muajin janar, Pentagoni pati vendosur luftimin e Pekinit së bashku me Rusinë në qendër të Strategjisë për Siguri Kombëtare. Sipas raportit të Pentagonit, pavarësisht prej parashikimeve për ulje të trendit të rritjes ekonomike, buxheti i Kinës për mbrojtje mund ta tejkalojë shifrën e 240 miliardë dollarëve deri më 2028. Në po të njëjtin raport është thënë se programi hapësinor i Kinës është duke u zhvilluar me shpejtësi.

## Sarec, kryeministër i ri i Sllovenisë

LUBJANË, 17 GUSHT - Independentisti Marjan Sarec u zgjodh të premten kryeministër i Sllovenisë në

krye të një koalicioni të minorancës së qendrës së majtë, i cili u votua në Parlament, 11 javë pas zgjed-

hjeve parlamentare të 3 qershorit.

Sarec, 40-vjeç, një ish-komedian, fitoi 55 vota nga 90 që

numëron në total Asambleja. Ai formoi një koalicion me pjesëmarrjen e pesë partive të qendrës së majtë.





# Turqi, kush është pastori që shkaktoi luftë tregtaro-diplomatike

Shoqata protestante në Izmir të Turqisë është e vogël. Ajo ka vetëm disa dhjetra besimtarë, të cilët rregullisht takohen në një hapsirë të vogël në një godinë. Në mesin e tyre rri ulur me kitarë në dorë Andrew Brunson, një amerikan, prift protestant. Luan me kitarë dhe këndon. Të paktën kështu tregojnë fotografitë e botuara në internet. Kështu ka qenë edhe në kishën e Izmirit, para se Brunson të arrestohej nga autoirretet turke dhe ky arrestim të përdorej si shkas për shkallëzimin e konfliktit mes SHBA-së dhe Turqisë.

## Rruga deri në Turqi

50-vjeçari Brunson me siguri që nuk ka mundur ta parashikojë një zhvillim të tillë të ngjarjeve në vitin 1993, kur për herë të parë erdhi në Turqi

pati. Më 2007 në Turqi u vra një misionar gjerman dhe dy persona të konvertuar. Por Brunson i ka mbetur besnik misionit të tij, më 2010 ai themeloi madje edhe kishën e ringjalljes në Izmir.

## Në vend të vazhdimit të viztës - arrestimi

Gjashtë vite më vonë, Brunson deshi të vazhdonte vizën e tij në Turqi. Por në fund të vitit 2016 ai u arrestua në valën e arrestimeve pas puçit të dështuar kundër Erdoganit. Edhe bashkëshortja e Brunsonit u mbajt disa ditë nën masa arresti. Ndërsa Brunson akuzohet, pas 63 ditësh në arrest, për anëtarësi në grupet terroriste, spiunim, bashkëveprim dhe planifikim të puçit si dhe mbështetje të partisë së ndaluar kurde, PKK.



kërkesë. Por kërcënimet dhe lufta tregtare mes SHBA dhe Turqisë ndërkohë janë përshkallëzuar. Trumpi e konsideron si shumë të rëndë-

sishëm grupin e votuesve të këtij besimi. Zëvendëskryetari Mike Pence edhe vet prezantohet si evangjelist i madh. Ndërkohë gjendja shëndetsore

e Brunsonit është përkeqësuar. Vajza e tij thotë, se Brunson ka humbur ndërkohë 25 kilogram dhe nuk është mirë me shëndet. (gazeta-Shqip.com)



së bashku me bashkëshorten e tij Norine. Ai erdhi nga vendi i vogël Black Mountain në Karolinën Veriore, ku feja protestante është pjesë e pandashme e jetës së përditshme dhe ku tradicionalisht votohet për republikanët. Çifti Brunson i përket grupit të besimtarëve evangjelistë, një kishë protestante me botëkuptime liberale. Ashtu si të gjithë besimtarët e tjerë edhe familja Brunson beson tek misionet. Ndaj edhe kanë pranuar që të ndërmarrin një mision fetar në Turqi, në një vend kur 99 % e popullatës i përket besimit islam. Misionet fetare lejohen në Turqi, por nga viti 2003 nuk shihen me sim-

SHBA dhe bashkësia ndërkombëtare janë të mendimit se këto akuza janë të pabaza. Brunson ka pranuar se kohë pas kohe ka udhëtuar edhe në zonat e banuara me kurdë, por atje është kujdesur për refugjatët. Nuk ka asnjë dëshmi që ai ka qenë pjesë e përpjekjeve për rrëzimin e regjimit të Erdoganit. Brunson pohon se është i pafajshëm dhe se kurrë nuk ka lejuar që politika të futet në kishën e tij.

## Refuzimi amerikan

Presidenti amerikan Donald Trump e ka refuzuar këtë



## Scarlett Johanssoni, aktorja më e paguar në botë



**P**araqitja e saj në "The Avengers" e kanë ndihmuar aktoren Scarlett Johansson të shndërrohet në aktoren më të paguar më së miri në botë, ka bërë me dije revista "Forbes". Johansson, e cila shfaqet në rolin e Black Widow në filmin "Avengers",

ka fituar 40.5 milionë dollarë gjatë vitit të kaluar. Angelina Jolie radhitet në vendin e dytë me 28 milionë dollarë, të cilat i mori nga filmi "Maleficent 2". Në këtë listë e treta është Jennifer Aniston, ndërsa Gal Gadot e "Wonder Woman" është radhitur e dhjeta.



## Rita Ora krenare, një rrugë në Prishtinë i vihet emri i gjyshit të saj

**E**rritur në Londër, por me famë botërore, Rita Ora nuk e mohoi asnjëherë origjinën nga Kosova. Një rrugë në Prishtinë tashme është emëruar me emrin e gjyshit të Ritës, gjë që nuk kaloi pa u komentuar edhe nga ajo. Rita Ora para miliona ndjekësve ka postuar në rrjetet sociale fotografinë ku ndihet falënderuese, njëkohësisht krenare për veprën e gjyshit të saj, Besim Sahatçiu.



MY GRANDFATHER WAS ONE OF THE FIRST DIRECTORS TO COME OUT OF KOSOVO I'M SO PROUD HE WAS SO FEARLESS NOW HE HAS HIS OWN STREET IN OUR HOMETOWN PRISTINE


## Kimi mahnitë në të verdhë



**A**jo është duke punuar tashmë për muaj të tërë për t'i arritur format e për kryera. E Kim Kardashiani duket se është në rrugën e dukur. Ajo është parë këtë javë në Miami e veshur

me një fustan të verdhë dhe duket fantastike. Ylli 37-vjeçar la pak për imagjinatën e veshur në fustanin e shkurtër dhe të ngushtë, të cilin e kombinoi me një palë këpucë transparente.

## Selena rihap llogarinë në "Instagram"



**S**elena Gomez ka ndarë me fansat e saj disa çaste të pushimeve. Ajo dhe miket e saj të ngushta po kalojnë disa ditë nën rrezet e diellit e po shëtitën në jaht. Ndonëse Gomez nuk tregoi loka-

cionin, në fotografi shihet se po kënaqet. Kjo seri fotografish e këngëtares vjen pas një kohe të gjatë që nuk kishte postuar në rrjetet sociale, edhe pse është më e ndjekura në "Instagram".



<b>Autor: GAZMEND MORINA</b>	SHTETI MË I VOGËL NË BOTË	MBISHKRIMI NË NJË GUR VARRI	NUK NXJERR ZË A FJALË NGA HABIA A NGA FRIKA	AKTORJA SUEDEZE MARGRET	KRYEQYTETI I LETONISË	SHKENCA QË STUDIOUË NDËRTIMIN E FORMËN E ORGANIZMAVE TË GJALLA (pashq.)
NJË PLANET						
GADISHULL NË EVROPË						
REGJISORI I FAMSHËM BURTON				GANA, ANGOLA LLOJ DELTINE, QERAMIKA		
QËNDRUESHMËRI NDAJ SFIDAVE (arab.)						
AKTORJA ME FAMË BOTËRORE HUDSON					ZANORE I CAKTOVA NË NJË POZITË A DETYRË, I EMËROVA	

# SUDOKU

		9			4				
6	7					1	9	5	
				5	8				
			3			6		9	
5									7
	2			8			4		
					5	3			
	4	1	9					7	6
					6				2

<b>EPOKA E RE</b>	AKTORJA AMERIKANE NË FOTO JOHANSON (shqip.)	LUGINË SHKËMBORE NËPËR TË CILËN KALON NJË LUMË	LIDHJE, BASHKIM	KAMION I VOGËL	SHKRONJË GREKE	ZANORE RI EMETIMI	MINISTRI I JASHTËM SUEDEZE BILD	MIMOZANI OSMANI DY BASHKËTINGËLLORE	DËSHTIM I LINDJES SË FOSHNJËS GURRË (sh.shq.)				
LLOJ MOTOÇIKLETE JO SHUMË E MADHE	◯						TËRËSIA E KUSHTEVE METEOROLOGJIKE						
SECILA NGA FLETËT QË MBYLLIN DRITAREN	◯						ANKESA DY ZANORE						
PUNËTOR I TEATRIT TË KUKULLAVE	◯							NJË PREJ FIGURAVE STILISTIKE ISH FUTBOLLISTI SHEARER (orgj.)					GRIMCOJ (bised.)
"... DE ZHANIERO"	◯			NGRËNIA E USHQIMIT NË MBRËMJE	DRAMATURGU ARBËRESH JOSIP ... ROUBINI GLOBAL ECONOMICS			OSMANI ZANORE					
KRYEQYTETI I NJË SHTETI TË MADH EVROPIAN	◯					KËNGËTARJA SOPJANI	AKTORJA HOLIVUDIANE ... TYLER PJESË E LOJËS NË TENIS		TITAN TITULL I SULLTANIT NË PERANDORINË OSMANE (shq.)			ERMAL MAMAQI EMNAKJA E EMRIT TË AKTORI ... ISLAMI	
ESTONIA, NORVEGJIA	◯			ISH "MISS ALBANIA" VUTHAJ PJESË E MEKANIKËS				OSE PËREMËR PRONOR				I PARI (Sport) DY ZANORE	
BASHKËT.	◯	QYTET I MADH NË GJERMANI (shq.) QË KA TË BËJË ME MINIERËN							KUVENDI POPULLOR I ATHINASVE TË LASHTË LLOJ PAPANALLI				XEHETAR
<b>EPOKA E RE</b>	SHOK, JARAN MODELI I SAKTË E I ZVOGËLUAR I NJË OBJEKTI				GOJËDHËNË FIGURË QË PARAQET AKTORI NË SKENË			KRYEQYTETI I NJË SHTETI EVROPIAN (pashq.) "... SIRO"					BASHKËT. KAFSHË E MADHE QË JETON NË OQEANË
PJESË E XHAMISË KU HIPËN MYEZINI (sh.shq.)							SHTET NË AZI FEUDAL QË I NËNSHTROHEJ MBRETTIT					... NOKSHIQI ZANORE	
AKTORJA ANGLEZE ... FRIEL					KRYEQYTETI KANADEZ QË DO ZGJIDHJE SHUMË TË SHPEJTË				VALË E NXEHTË AJRI QË VJEN NGA ZJARRI (shq.) KRYEQYTETI JORDANEZ (pashq.)			KYÇ SHTET (huaj)	
REFORMATORI I TURQISË ATATURK (shq.)						SKAJI, QOSHJA NJËSI PESHE (vjet.)			DY ZANORE ASSOCIATION KORFBALL ENGLISH			ERMELA (perkdh.) KRYEPROKURORJA E SHQIPËRISË ... RAMA	
KITARISTI I FAMSHËM KLEPTON					SUPER MODELJA ANGLEZE KATE ...								
SHTAGA E BILARDOS													ISH KRYEMINISTRI I SHQIPËRISË FATOS ... BASHKËT.
PASURIA E PATUNDSHME QË SILLTE TË ARDHURA (vjet.)													AI QË RUAN PATAT (pashq.)

ZGJIDHJA E FJALËKRYQIT: VENERA, APENIN, TIM, GA, ITIKAT, KATE, O, AFERIM, NIMANI, AKSI, I, MO, ABORT, SKUTËR, KLIMA, AL, R, KNATRI, ANKIMI, EBI, ANIMATOR, ANAFORA, RIO, RELA, OTOMANI, LONDRA, LIV, TI, EM, EN, AGNESA, APO, ASI, T, DRESDENI, AGORA, MIK, MIT, MADRID, M, MINARET, SIRIA, ABI, ANA, OTAVA, AFSHI, AN, KEMALI, ANA, AO, ELA, ERIK, MOS, MAHNITET, TAKU, IKACAKI, NANO, IRATI, ALINE, PATAR, ZGJIDHJA E SUDOKU: KOIIONA I:195 647 822; KII:678 231 954; KIII:432 589 761; KIV:783 416 295; KV:514 392 687; KVI:926 875 413; KVII:269 753 148; KVIII:41 928 576; KIX:87 164 329.



E jashtëzakonshme

### Ndërroi gjininë në moshën 81-vjeçare

Ruth Rose, tani 85-vjeçare, ka bërë me dije se nuk kishte dëgjuar më herët që mund të kryejë ndërhyrje për ndërrimin e gjinisë derisa i ka treguar një mjek. Ajo u rrit si një djalë i quajtur Xhejms, por dëshirën për të qenë grua e kishte pasur që kur ishte nëntë vjeç. Rose ndërhyrjen për ndërrimin e gjinisë e bëri në moshën 81-vjeçare, duke inkurajuar kështu njerëzit që ta "kënaqin" vetën nëse e dëshirojnë një gjë të tillë.



FOTO E DITES



Një motoçiklist i ushtrisë indiane kryen një aktivitet gjatë festimit të Ditës së Pavarësisë së Indisë në Bangalore. /AP/

E rrallë

### Veshja e çuditshme që kushton vetëm 13 euro

Ne shpesh mbajmë në duar çadra të cilat shpesh i humbim, na prishen për shkak të erërave të forta dhe nuk na kryejnë punë. Si pasojë e stuhive të shumta në Britani, tani kanë filluar të prodhohen çadrat në formë të xhaketës e cila është shumë atraktive, kostoja e së cilës është rreth 11 funte (13 euro). Këto veshje prodhohen nga kompania "Blue Crate", që përmban një kapuç të papërshkueshëm nga uji dhe një mburojë të madhe në shpatulla për mbrojtje nga shiu.



**BARSOLETA E DITËS**



**Mësuesi, nxënësit:**  
- Ma thuaj emrin e një qyteti në Angli.  
- Për cilin qytet e keni fjalën?



**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

Vetëm gjate vikendit në ora 16:00

**"INCREDIBLES 2" 3D**

I Animuar/Aksion/Aventure; 1 ore 58 min

**Rolet:** Holly Hunter, Craig T. Nelson, Sarah Vowell, Huck Milner, Samuel L. Jackson, etj.

**Regjia:** Brad Bird



Në ora 18:20

**"FUTURE WORLD" 3D**

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

**Rolet:** James Franco, Suki Waterhouse, Milla Jovovich, Lucy Liu, Jeffrey Wahlberg, Snoop Dog, etj.

**Regjia:** James Franco



Në ora 20:00

**"ANT-MAN AND THE WASP" 3D**

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 58 min

**Rolet:** Paul Rudd, Evangeline Lilly, Michael Pena, Michael Douglas, Michelle Pfeiffer, Laurence Fishburne, etj.

**Regjia:** Peyton Reed



Në ora 22:00

**"LOVING PABLO" (R)**

Biografi/Krim/Drame; 2 ore 03 m

**Rolet:** Javier Bardem, Penélope Cruz, Peter Sarsgaard, etj.

**Regjia:** Fernando León de Aranoa



**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**




**DASHI**

Edhe pse do të keni shpenzime, do të rikuperoni shumë shpejt financat tuaja falë një investimi që keni bërë kohë më parë.



**DEMI**

Megjithëse ju duket sikur vendimet tuaja nuk i kanë dhënë frytet e tyre, duhet të prisni për t'i parë rezultatet e para.



**BINJAKËT**

Dita e sotme paraqitet e qetë me rutinën e zakonshme të punës ose studimit për ata që janë në shkollë. Një marrëveshje biznesi po ju intrigon.



**GAFORRJA**

Edhe pse i keni planetët kundër shenjës suaj sot, do të arrini t'i ekuilibroni ndjenjat dhe situatat e komplikuara që ju paraqet dita.



**LUANI**

Sot çdo gjë po e bëni me qejf dhe dëshirë, madje edhe ato çështje që ju janë ofruar nga puna juaj. Si për çudi, do t'i zgjidhni në një kohë të shkurtër.



**VI RGJËRESHA**

Jeni pak të shqetësuar me disa situata që po verifikohen në ambientin familjar. Duhet të gjeni një zgjidhje sa më parë.



**PESHORJA**

Edhe pse partneri duket shumë i mërziur dhe rebel, sot do të jeni ju që do ta merrni në dorë situatën dhe çdo gjë do të qetësohet.



**AKREPI**

Keni lënë shumë gjëra pa mbyllur në punën tuaj dhe sot do të rriini me orë të gjata në zyrë për të përfunduar.



**SHIGJETARI**

Edhe pse ju kanë rekomanduar një ambient të caktuar dhe njerëz të besuar, intuïta juaj sot nuk do t'ju lejojë t'i ndiqni udhëzimet e të tjerëve.



**BRICJAPI**

Keni vendosur rregulla për mbarëvajtjen e gjërave në familjen tuaj, por ato nuk po respektohen. Do t'i kërkoni fajtorët.



**UJORI**

Ju pëlqejnë pushimet në këtë stinë dhe po planifikoni një shkëputje të shkurtër që do t'ju çlodhë dhe do t'ju rigjenerojë.



**PESHQIT**

Debate të ndezura për një projekt ku pjesëmarrja është e madhe. Gjithsecili kërkon t'i marrë meritat në fushën e vet.

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT  
PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

BRIGHTON - MAN UTD

2

BURNLEY - WATFORD

1

RAYO VALLECANO - SEVILLA

2

Sot (e shtunë) fillon edicioni 2018/2019 në IPKO Superligën e Kosovës në Futboll

# Llumnica: Katër skuadra luftojnë për titull

Analisti Ardian Llumnica e ka parashikuar kampionatin 2018/2019 shumë interesant, me rivalitet të theksuar në garën për titull. "Do të jetë kampionat interesant. Do të ketë rivalitet të madh për kreun dhe për mbijetesë. Federata ka marrë masat e nevojshme që çdo dukuri negative ta eliminojë apo minimizojë, ndërsa është ngritur edhe vetëdija e klubeve se ndeshjet duhet të luhen në suaza të 'fair-play'-it dhe fituesit vetëm duhen uruar qoftë brenda apo jashtë fushës", ka thënë Llumnica, i cili ka nxjerrë katër skuadra si favorite për titull: Prishtinën, Dritën, Feronikelin dhe Llapin

**EPOKA E RE**

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 17 GUSHT - Sikurse në shumicën e vendeve të tjera evropiane, edhe Superliga e Kosovës në futboll nis në këtë fundjavë. Analisti i futbollit, Ardian Llumnica, ka thënë të premtën për "Epokën e re" se edicioni 2018/2019 do të jetë interesant në garën për titull dhe për mbijetesë. "Do të jetë kampionat interesant. Do të ketë rivalitet të madh për kreun dhe për mbijetesë. Federata ka marrë masat e nevojshme që çdo dukuri negative ta eliminojë apo minimizojë, ndërsa është ngritur edhe vetëdija e klubeve se ndeshjet duhet të luhen në suaza të 'fair-play'-it dhe fituesit vetëm duhen uruar qoftë brenda apo jashtë fushës", ka thënë Llumnica.

Në edicionin e fundit titullin e kampionit e ka fituar skuadra e Dritës nga Gjilani, por Llumnica ka shprehur mendimin se edhe në edicionin e ri gara për trofeun më të çmuar në futbollin e Kosovës do të sjellë rivalitet të madh në mes të disa skuadrave. "Lufta për titull edhe këtë vit do të jetë e fortë. Mendoj se do t'i ngjasojë sezonit që lamë pas, dhe jo vetëm në këtë vit, por edhe për disa vjet të tjera do të ketë disa skuadra që do të garojnë për titull me cilësi thujse të përafërt ku dallojnë në nuanca. Në këto raste fjalën përfundimtare për sukses mund ta thonë trajnerët për nga mjeshtëria e tyre", ka shtuar ai.

Favorite në këtë garë, sipas Llumnices, do të jenë Drita, Prishtina, Feronikeli dhe Llapi. "Drita dhe Prishtina si ish-kampionet dhe nënkampionet janë prapë favorite. Drita, pavarësisht se ka ekip homogjen, duhet të ketë më shumë konkurrencë të brendshme dhe disa prej përforcimeve



nuk janë aq bindëse. E shoh një Prishtinë më ndryshe nga sezoni i kaluar edhe në cilësi, edhe në ritëm të lojës. Kur kësaj ia shton edhe rikthimin në shtëpi të vet, adaptimin e trajnerit Josa në futbollin e Kosovës, atëherë është pretendentja kryesore për titull. Në këtë garë janë edhe Feronikeli dhe Llapi. 'Nikli' në përbërje ka kontingjent për dy formacione dhe nëse Starova kap ritmin në lojën sulmuese, atëherë do ta udhëheqë kreun. Llapi ka skuadrën më të mirë ndonjëherë, pasi ka ruajtur kontingjentin dhe ka marrë futbolistët Bujar Idrizin, Fiton Hajdarin, Behar Maliqin e shumë të tjerë që janë superiorë në nivel të Superligës. Llapit ndër vite e ki munguar konkurrenca e brendshme apo kontingjenti, por tash e ka të plotësuar këtë element, kurse e ka edhe trajnerin Bylbyl Sokoli që e di rrugën e suksesit. Nëse Llapit nuk i shfaqet ndonjë problem i natyrës që iu shfaq ende pa filluar kampionati, atëherë është favorit i barabartë me Prishtinën dhe Feronikelin", ka deklaruar Llumnica. "Mendoj se KEK-u nuk mund t'i shpëtojë mbijetesës. Problemet në

kryesi dhe fondi i futbollistëve të rinj lë për kuptuar se rënia i troket në derë, kurse skuadrat e tjera afërisht janë të ngjashme në cilësi dhe dikush më poshtë e dikush më lart do të mund t'i ikin barazhit. Kanë bërë transferime aq sa kanë pasur mundësi dhe aq sa pretendojnë, por ka edhe nga ato skuadra që janë vonuar dhe nuk kanë gjetur lojtarë të duhur në treg", ka përfunduar Llumnica.

## Fazliu: Do ta mposhtim '89-shin

Sulmuesi Astrit Fazliu ka thënë se skuadra e Feronikelit është përgatitur për ta mposhtur Trepçën '89 në ndeshjen e parë për kampionatin 2018/2019. "Është ndeshja e parë që e hap sezonin dhe ne jemi përgatitur maksimalisht për këtë ndeshje. Atmosfera dhe gjendja në ekip është shumë e mirë dhe po besojmë se do të shënojmë fitore. Kundërshtari ynë është një ekip me traditë në futbollin tonë, por jemi të mobilizuar për ta nisur kampionatin me fitore", ka thënë Fazliu për "Epokën e re".

## SHKURT

### Avdijaj huazohet te Willem II

Futbollisti shqiptar Donis Avdijaj është huazuar në skuadrën e Willem II në Holandë. Reprerentuesi i Kosovës ishte pjesë e Rodas në Eredivisie teksa në 11 takime me këtë skuadër realizoi 3 gola.

### Manxholli përforcon Besën

Portieri i Trepçës '89, Enis Manxholli është huazuar te skuadra e Besës së Pejës.

Lajmin e ka konfirmuar skuadra mitrovicase në faqen zyrtare në "Facebook", kurse portieri Manxholli do të luajë në Ligën e Parë me skuadrën pejane, duke synuar rikthimin në Ipko Superligë.

### Loci dhe Selmani ndihmëstrajnerë të Damir Mulaomeroviçit

Ish-basketbollisti dhe trajneri shumëvjeçar, Bujar Loci është emëruar ndihmëstrajner i parë i përzgjedhësit Damir Mulaomeroviç, kurse pas tij është Ilir Selmani, po ashtu ish-basketbollist dhe aktualisht trajner, si dhe Andin Rashica, i cili edhe më parë ka qenë pjesë e Përfaqësueses së Kosovës. Trajner kondicional i Përfaqësueses do të vazhdojë të jetë Ugur Vural nga Turqia. Mulaomeroviç do të nis punën me Përfaqësuesen e Kosovës që nga data 29 gusht, kur edhe do të fillojë përgatitjet për ndeshjen kundër Maqedonisë që do të zhvillohet në Prishtinë më 13 shtator në kuadër të FIBA Eurobasket 2021 Pre-Qualifiers.

### Mustafi: Duhet të kemi guxim ndaj Chelseat

Shokdran Mustafi ka kërkuar nga bashkëlojtarët e tij që të mos kenë frikë nga gabimet në ndeshjen e ardhshme kundër Chelseat në kuadër të Premierligës. "Të luash kundër Manchester Cityt nuk është e lehtë. Ndoshta kundër ekipeve mund t'i evitosh një apo dy gabime. Ndeshja e radhës është Chelsea, nuk duhet të bëjmë shumë gabime. Por nëse ke frikë nga gabimet ato atëherë ndodhin. Ne duhet të jemi të sigurt në atë që dëshirojmë ta bëjmë. Ai m'i tregoi gjërat e mija pozitive në lojë dhe në çfarë duhet të punoj. Jam i lumtur sepse është e vështirë kur nuk e di se në çfarë duhet të punosh sepse askush nuk të tregon", ka thënë Mustafi.

## IPKO Superliga

Të shtunën takohen:  
16:45 Feronikeli - Trepça '89

Të dielën takohen:  
16:45 Drita - KEK-u  
16:45 Liria - Ballkani  
16:45 Flamurtari - Ferizaj  
16:45 Llapi - Drenica

Të hënën takohen:  
19:45 Prishtina - Gjilani


## Unitedi përfundimisht "blindon" Pogban

MANCHESTER, 17 GUSHT - Pas lajmit të fundit të tabloidit britanik "The Sun", që zbuloi bisedën mes Mourinhos dhe mesfushorit francez Paul Pogba, çka vërtetonte se marrëdhënia e tyre është në

krizë, të premtën kjo media ka shtuar një episod të ri, sipas të cilit, Pogba nuk do të largohet nga "Old Trafford". "Manchester United nuk do ta shesë Pogban përkundër interes-

imit të Barcelonës..., edhe pas konfliktit me Mourinhon", shkruan "The Sun". Ed Woodward, zëvendëspresident ekzekutiv i "Djajve të Kuq", ka konfirmuar se Paul Pogba

është një prej lojtarëve të mëdhenj dhe për këtë arsye mbetet më i rëndësishmi në klub jo vetëm në planin sportiv, por edhe në atë komercial.



## KB Peja: Vendimi i FBK-së, skandaloz

PRISHTINË, 17 GUSHT - KB Peja ka reaguar pas përjashtimit nga garat nga ana e Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK). Skuadra pejane vlerëson se misioni i federatave është masovizimi i sportit, kurse i FBK-së është shkatërrimi i sportit duke shuar klube për interesa personale dhe duke mos jap asnjë ndihme në kalimin e situatës në të cilën gjendet klubet jo vetëm KB Peja, por edhe shumë klube tjera në Kosovë. "Klubi i Basketbollit Peja reagon ndaj vendimit për përjashtimin nga garat e FBK-së ku ishte një vendim skandaloz. Misioni i federatave është masovizimi i sportit kurse i FBK-së është shkatërrimi i sportit duke shuar klube për interesa personale dhe duke mos jap asnjë ndihme në kalimin e situatës në të cilën gjendet klubet jo vetëm KB Peja por edhe shumë klube tjera në Kosovë. KB Peja është njëra ndër klubet më të suksesshme sportive në vend. Si shumë klube tjera, edhe më të mëdha se ne, kemi kaluar nëpër krizë financiare e cila s'ka qenë e lehtë fare dhe vazhdon të jetë edhe sot. Por përkundër vështirësive, kemi gjete prapë forcën që të vazhdojmë përpara. Klubi ka qenë i dënuar padrejtësisht me disa vendime, që pa pasur mundësi financiare dhe eksperiencë për çështje të tilla juridike i kemi humbur rastet në gjykatën e arbitrazhit të basketbollit BAT", thuhet nw njoftimin e KB Peja. "Klubi është dënuar me 5,000CHF dënim nga FIBA. Pas kësaj, na është caktuar afat deri me 15 Shtator për të lëvizur me rastet sepse në të



kundërtën, dënimin tjetër do të paguhej nga FBK. Me këtë rast, FIBA ka kërkuar nga Federata të ndërmerren masat dhe Klubi ose të shuhet ose të lëviz në aspektin e mbylljes së obligimeve. Klubi mblodhi forcat që të punoj në këtë drejtim dhe deri sot nga 3 rastet, 1 e kemi mbyllur me marrëveshje dhe dy të tjera kemi rënë në pajtim në parim dhe presim shumë shpejt finalizimin e tyre. Për dënimin prej 5,000CHF Klubi ka kërkuar nga FIBA që të mundësohet të paguhet me këste. FIBA përmes email ka konfirmuar që Klubi ka lëvizur për rregullimin e borxheve dhe që dënimin prej 5,000CHF mos të jetë prioritet por të jenë tre rastet e arbitrazhit dhe se dënimin mund të priste deri në një afat tjetër, i cili do caktohet më vonë", thuhet nw njoftimin. KB Peja pretendon se e ka njoftuar zyrtarisht e jo zyrtarisht gjatë gjithë kohës FBK-në me lëvizjet. Sipas klubit pejan agentët, lojtarët dhe FIBA janë shprehur mirënjohës ndaj procesit dhe kanë kërkuar që klubi të vazhdojë në këtë mënyrë që

me datë 15 shtator të mund të hiqte ndalesën dhe të mund të regjistronte lojtarët në mënyrë të rregullt. "Ne nuk kemi asnjë njoftim zyrtar nga FBK në lidhje me vendimin që e ka marr FBK, ne jemi njoftuar nga mediet për vendimin e FBK ku edhe shihet se sa jo serioze tregohet FBK dhe mundohet në mënyrë arbitrare të na largoj nga garat duke na pamundësuar edhe të drejtën që e kemi me kundërshtua vendimin e FBK. Klubi këtë sezon, duke shfrytëzuar edhe ligjin për sponzorizime, i cili përkundër që është ende i mangët dhe gjen zbatim fare pak, kemi planifikuar një buxhet që garanton pagesën e obligimeve si dhe mbajtjen e një ekipe stabile shumë mirë të organizuar. Madje, Klubi arriti që të rezervonte një vend edhe në Ligen Ballkanike pas zgjidhjes së situatës me FIBA. Federata në mënyrë arbitrare ka vendosur që ta largoj Pejën nga garat. Federata në mënyrë arbitrare dhe tërësisht të parregullt dëshiron të ju jep mundësinë klubeve sekondare, klubeve të inatit të cilët nuk kanë as histori e as buxhet e financa, që përmes Wild Card-es të rikthehen në Superlige. E kanë obligimin, sepse kanë jap premtim gjatë fushatës për të parin e Federatës. E kuptojmë z. Fetahu i cili ishte nevrikosur shumë atëherë kur u munduan në të gjitha mënyrat për të na larguar nga liga", thuhet nw njoftimin e klubit pejan. KB Peja vlerëson se është viktimitë e një hakmarrje të ulët, për mos përkrahjen e kësaj klike të interesave të ngushta.

## Williamsi: Më mungon agresiviteti

LONDËR, 17 GUSHT - Pas eliminimit të shpejtë në turneun Masters të Sinsinatit këtë javë, tenisista amerikane Serena Williams ka nisur përgatitjet për grand slam të US Open, turneun e shtëpisë, ku nuk fiton prej dy vjetësh. Një vit më parë në këtë periudhë ajo përgatitej për t'u bërë nënë dhe tani do të luajë para publikut të vet me shpresën për të arritur një tjetër rezultat të mirë, pas daljes në finalen e Wimbledonit. "U argëtova në Londër, por tani do të luaj para publikut tim dhe e di që ai pret shumë nga unë, ndaj nuk dua ta zhgënjej, pasi e di se mbështetja do të jetë e madhe", ka thënë ajo. Ish-numri 1 në botë e ka të qartë se duhet të ndryshojë diçka në lojën e saj, në mënyrë që të përshtatet më mirë me sipërfaqen e re (fushat me çement). "Duhet të shërbej më mirë në mënyrë që të jem më agresive dhe kjo gjë të jetë konstante, pasi edhe rivalët do të vihen në vështirësi në pritjen e topit të parë. Kjo do t'i evitojë shkëmbimet e gjata të topit dhe



lodhjen e shpejtë fizike. Duhet t'i përmirësoj edhe disa gjëra në mënyrën time të lojës. Më pëlqen të luaj në

fushën qendrore të US Openit në orët e vona të mbrëmjes, ku kam fituar dhe humbur", ka shtuar Williamsi.

### SHKURT

#### Hasani nënshkruan në Arabi me Al Raedin

Ferhan Hasani ka nënshkruar me skuadrën Al Raed nga Arabia Saudite. Sulmuesi nga Tetova deri më tani ishte pa klub, por vendosi ta vazhdojë karrierën në Arabi. Hasani ka nënshkruar kontratë njëvjeçare me përfitime prej 1.2 milionë dollarësh apo diçka më shumë se një milion euro. Paraprakisht për 'Bubën' spekulohet se karrierën do ta vazhdojë në Turqi por, si duket, nuk ka mundur të arrijë marrëveshje me klubet turke. Hasani ishte një ndër futbollistët më të mirë të Shkëndija duke i ndihmuar ta rikthejë edhe titullin kampion të Maqedonisë. Ai më herët ka luajtur për skuadrën e madhe gjermane Wolfsburg dhe atë daneze Brøndby.

#### Marchisio pas 25 vjetësh largohet nga Juventus

Në ditën e fundit të afatit kalimtar që lejon futbollin italian, kampionët e Serisë A u privuan nga një emër që do të mbetet në historinë e klubit bardhezi. Juventus njoftoi në mënyrë surprizë shkëputjen me konsensus të Claudio Marchisio. Mesfushori i rritur në ekipet e moshave vendos të largohet nga "Zonja e Vjetër" pas plot 25 vjetësh, nga të cilët 11 i ka kaluar në skuadrën e parë. Claudio Marchisio, i tentuar nga oferta joshëse e Montreal Impakt dhe i ndikuar nga minuta e pakta që i ka rezervuar në muajt e fundit trajneri Allegri, shkëputi akordin me torinezët pas 294 ndeshjeve dhe 33 golave, periudhë në të cilën koleksionoi shtatë tituj kampion radhazi, tri superkupa të Italisë dhe 4 kupa Italie radhazi. Numri 8 i Juventusit, aq i dashur për tifozët, zgjodhi rrjetin "Instagram" për t'i përhëndetur të gjithë ata që e mbështetën.

#### City: De Bruyne mungon tre muaj

Manchester City ka konfirmuar se Kevin de Bruyne do të mungojë tre muaj. Mesfushori belg ka pësuar një lëndim serioz në gjurin e këmbës së djathtë gjatë stërvitjeve me klubin anglez. "Ne mund të konfirmojmë se De Bruyne ka pësuar një lëndim të ligamentit lateral (LCL) në gjurin e djathtë. Nuk kërkohet asnjë operacion, por mesfushori pritet të jetë jashtë përreth tre muaj", thuhet në njoftimin e Manchester City.

#### Cerci transferohet në Turqi

Sulmuesi italian Alessio Cerci është transferuar në Turqi. Ai ka nënshkruar një kontratë trevjeçare me klubin turk MKE Ankaragucu. 31-vjeçari italian ka qenë një agent i lirë pas përfundimit të kontratës së tij me Hellas Veronën. Sipas burimeve të shumta, ai ka nënshkruar marrëveshje me një pagë prej 1.1 milion eurosh për stinor. Cerci u kërkua edhe nga Bursaspori.

#### Laxalt dhe Castillejo në Milan

AC Milan e mbylli përfundimisht afatin kalimtar me transferimin e dy futbollistëve. Bëhet fjalë për Diego Laxalt nga Genoa dhe Samuel Castillejo Azuaga nga Villarreal. "Me ardhjen e Bakayokos, Castillejo dhe Laxalt, AC Milan i përfundon operacionet hyrëse të këtij sezoni të afatit kalimtar", thuhet në njoftimin e klubit kuqezi. Carlos Bacca përfundimisht transferohet në Villarreal, kurse Gianluca Lapadula në Genoa.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Nr. 01-111-125966  
Datë: 17.08.2018



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, Komuna e Prizrenit, shpall:

### KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

Drejtoria e Administratës  
Pozita – Mbështetës teknik  
Koefficienti – 5.5

Lloji i vendit të punës: me afat të pacaktuar, me orar të plotë (periudha provuese 6 muaj)  
Nr. i ekzekutuesve: 1 (një)

#### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ofron mbështetje teknike dhe operative për Drejtorinë e Administratës;
- Mbështet qendrën për shërbim me qytetarë;
- Mbështet Sektorin e Arkivës dhe Protokollit në arkivimin dhe shpërndarje të postës;
- Mbështet Sektorin për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore;
- Kryen edhe detyra tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

#### Shkathësitë e kërkuara:

- Njohuri profesionale në fushën e shërbimeve administrative;
- Shkathësi hulumtues, analitike, vlerësues të informacionit;
- Aftësi për përmbyshje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathësi kompjuterike të programeve (Word, Excel, PowerPoint, Internetit);

#### Kushtet:

- Shkolla e mesme
- Trajnime të ndryshme

#### Dokumentacioni i kërkuar:

- Fotokopja e Letërnjoftimit
- Ekstrakti i lindjes
- Dy - rekomandime (nëse keni)
- Diploma e Shkollës së mesme
- Certifikata të trajnimeve
- Certifikatën që nuk jeni nën hetime.

**Konkursi ngel i hapur 15 ditë kalendarike** nga dita e publikimit, duke filluar nga data e publikimit më 17.08.2018 deri më datën 31.08.2018 që konsiderohet si ditë e fundit e mbylljes së konkursit. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen. **Instruksione Aplikimi:** Kërkesa (Aplikacioni) për punësim gjendet në  [Njoftimet i gjeni në Ueb, ndërsa në rast nevojë mund të na kontaktoni në, tel: 038 / 200 44715 prej orës 08:00 – 16:00. Aplikacionet e pranuar pas afatit të pacaktuar konsiderohen të pranueshme, nëse data në dërgesën postare, ose çfarëdo dëshmie tjetër për datën e dërgimit, dëshmon se ajo është dërguar para kalimit të afatit për dorëzimin e aplikacioneve. Konkursi është i barabartë për të gjithë kandidatët e synuar, pa asnjë lloj diskriminimi ashtu siç parashihet me Ligjin Nr. 03/L-212 të Punës.](https://kk.rks-gov.net/prizren/category/konkurset-njoftimet/aplikacione/dhe-pas-plotësimit-sipas-çdo-pike-të-aplikacionit,-i-bashkëngjitni-dokumentet-të-cilat-kërkojnë-sipas-konkursit-dhe-mund-të-aplikoni-tek-ne-drejt-përdrejtë--Adresa-jonë:-në-sportelin-e-pranimit-nr.-2,-në-objektin-e-administratës-komunale-në-Komunën-e-Prizrenit,-rr.-)

Zyra e Personelit



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

No. 01-111-125966  
Tarih: 17.08.2018



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

03/L-212 İş Yasasının 8. Maddesi, kamu sektöründe konkur süreçlerin düzenlenmesi ile ilgili 07/2017 sayılı (ÇSRM) İdari Yönetgenin 4. Maddesi gereğince Prizren Belediyesi işbu konkuru ilan eder:

### İŞ YERLERİN DOLDURULMASI İÇİN KONKUR

#### Yönetim Müdürlüğü

Konum – Teknik Destek

Maaş seviyesi – 5.5

İşyeri türü: belirli bir süre ile, tam zamanlı (deneme süresi 6 ay)

İracı sayısı: 1 (Bir)

#### Görev ve sorumluluklar:

- Yönetim Müdürlüğü için teknik ve operativ destek sunar;
- Halka hizmet merkezini destekler;
- Arşiv Sektörünü, arşivleme protokolünü ve posta dağılımını destekler;
- İnsan hakları ve cinsiyet eşitliği ile ilgili sektörü destekler;
- Gözlemleyici tarafından zaman zaman makul olan yasa ve yönetmeliklere uygun olarak istenebilen diğer görevleri de yerine getirir.

#### Gerekli beceriler:

- Yönetim hizmet alanında profesyonel bilgiye sahip olunması;
- Bilgileri araştırma, analitik ve değerlendirici beceri;
- Baskı altında görev ve çalışmaları yerine getirme becerisi;
- Bilgisayar becerisi (Word, Excel, PowerPoint, Internetit);

#### Koşullar:

- Lise mezunu
- Çeşitli çözümler

#### Gerekli olan belgeler:

- Kimlik kartı fotokopisi
- Doğum ekstresi
- İki tavsiye ( varsa )
- Lise diploması
- Eğitim sertifikaları
- Sicil kayıt belgesi.

**Konkur, 17.08.2018 yayımlanma tarihinden 31.08.2018 tarihine kadar yani konkurun kapanışına kadar yayımlandıktan 15 gün sonrasına kadar açık kalacaktır.** Bu süre zarfında iletilmeyen ve tamamlanmamış belgeler kabul edilmeyeceklerdir. **Başvuru talimatları:** Mürakat talebi <https://kk.rks-gov.net/prizren/category/Konkurlar/İlanlar/Başvurular> adresinde bulunmaktadır ve belge başvurunun her bir noktasına göre tamamlandıktan sonra, konkur gereğince talep edilen evraklar da eklenerek doğrudan Prizren " Remzi Ademaj " caddesi, Prizren Belediyesi yönetim binasının 2 numaralı kabul gişesine mürakat edebilir.

**DİKKAT:** Bildirileri Web'de bulabilirsiniz fakat ihtiyaç duymaz halinde 08:00-16:00 saatleri arasında 038/ 200 44715 telefon numarasından ulaşabilirsiniz.

Belirlenen süre sonrasında kabul edilen başvurular kabul edilmiş olarak nitelendirilir, eğer posta ileti tarihi ya da herhangi bir başka gönderi tarihi başvuru teslimat süresinden önce gönderildiği kanıtlanır ise.

Konkur, 03/L-212 sayılı İş Yasasında öngörüldüğü şekilde herhangi ayımcılık yapmadan, eşit bir şekilde tüm adaylar için açıktır.

Personel Dairesi



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyes

Br. 01-111-125966

Dana: 17.08.2018

Na osnovu člana 8 Zakona o Radu br. 03/L-212, člana 4 Administrativnog Uputstva, (MPMS) Br. 07/2017 za uređivanje procedura konkursa u javnom sektoru, Opština Prizren objavljuje:

### KONKURS ZA POPUNJAVANJE RADNOG MESTA

Direktorijati Administracije  
Pozicija – Tehnička podrška  
Koficijentat – 5.5

Vrsta radnog mesta: na neodređeno vreme, puno radno vreme (probni rad 6 meseci)

Broj izvršilaca: 1 (jedan)

#### Zadaci i odgovornosti:

- Pruža tehničku i operativnu podršku Direktorijatu Administracije;
- Podržava centar za usluge građana;
- Podržava Sektor Arhive i protokola u arhiviranju i raspodeli pošte;
- Podržava Sektor za ljudska prava i polnu jednakost;
- Obavlja i druge poslove u skladu sa zakonima i propisima koji mogu da se traže od strane supervizora povremeno.

#### Tražene veštine:

- Znatno iskustvo i znanje iz oblasti administrativnih usluga;
- Istraživačke, analitičke i veštine procene informacija;
- Sposobnost za ispunjavanje zadataka i rada pod pritiskom;
- Kompjuterske veštine za aplikacije programa (Word, Excel, PowerPoint, Internet);

#### Uslovi:

- Srednja škola
- Razne obuke

#### Tražena dokumentacija:

- Kopija lične karte
- Ekstrakt rođenih
- Dve preporuke (ako imate)
- Diploma srednje škole
- Certifikati obuka
- Potvrda da niste pod istragom.

Konkurs je otvoren 15 kalendarskih dana od dana objavljivanja, počevši od dana objavljivanja 17.08.2018 do dana 31.08.2018 koji se smatra zadnjim danom zatvaranja konkursa. Dostavljene aplikacije nakon predviđenog roka neće se primati i manjkave aplikacije će biti odbijene.

**Instrukcije za aplikaciju:** zahtev (Aplikacija) za zapošljavanje nalazi se na [www.kk.rks-gov.net/prizren/](http://www.kk.rks-gov.net/prizren/), i nakon popunjavanja prema svakoj tački aplikacije, priložite dokumenta koja se traže prema konkursu i možete aplicirati kod nas neposredno – Naša adresa: na šalteru prijema br.2, u objektu opštinske administracije u Opštini Prizren, ul. "Remzi Ademaj" b.b. -Prizren.

**PAŽNJA:** Obaveštenja možete naći na Web stranici, a u slučaju potrebe možete kontaktirati tel: 038/200 44715 od 08:00 – 16:00 časova.

Aplikacije primljene nakon određenog roka smatraće se primljenim, ako datum o dostavci zadnjeg dana roka ili bilo kakav drugi dokaz o slanju dokazuje da je ona poslata pre isteka roka za dostavu aplikacije. Konkurs je podjednak za sve kandidate, bez ikakve diskriminacije kao što je predviđeno Zakonom o Radu Br. 03/L-149.

Kancelarija Personala



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
Qeveria –Vlada –Government

MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA  
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme  
Department za Financije i Opste Sluzbe/Department of Finances and General Services

Divizioni i Burimeve Njerëzore

### NJOFTIM

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në bazë të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbyesit Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit të Shërbyesve Civil, njofton kandidatët se konkursi i brendshëm i datës 19.06.2018 për pozitën:

**Menaxher i/e Personelit** Ref: DFSHP 07/2018 në Departamentin e Financave dhe Shërbimeve të Përbashkëta anulohet.

Arsyeja për anulimin e procedurës së rekrutimit bëhet duke u bazuar në Vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës Nr.195/2018 të datës 10.08.2018 gjegjësisht e pranuar nga Arkiva Qendrore e MBPZHR-së me datën 16.08.2018. Andaj procedura e rekrutimit për pozitën e lartëcekur duhet të rishpallet.

Divizija Ljudski Resursa

### OBJAVA

Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja, na osnovu Zakona Br.03 / L-149 za Državne Službenike Republike Kosovo i Uredbom Br. 02/2010 o Postupcima Zapošljavanja Državnih Službenika, obaveštava kandidate da je interni (unutrašnji) konkurs od 19.06.2018 godine za položaj:

**Menadžer Osoblja** Ref: DFSHP 07/2018 na Departamentu za Finansije i Zajedničke Usluge ukida/se.

Razlog za ukidanje postupka zapošljavanja zasnovan je na Odluci Nezavisnog Nadzornog Odbora za Državnu Službu Kosova Br.195 / 2018 od 10.08.2018, odnosno primljena od Centralne Arhive MPŠRR-a od 16.08.2018. Prema tome, postupak zapošljavanja za gore navedeni položaj mora biti ponovo objavljivanje.

Prishtinë  
Dt. 17.08.2018

Zyrtare e Personelit  
Luljete Maliqi



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit/Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta –Ministry of Culture, Youth & Sports

DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME / DEPARTMENT OF FINANCES AND GENERAL SERVICES / DEPARTMAN FINANSIJA I GENERALNIH USLUGA

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE / DIVISION OF HUMAN RESOURCES / DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Data 17.08.2018

### NJOFTIM PËR ANULIMIN E KONKURISIT

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit bazuar në Vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Nr. 175/2018 të datës 10.08.2018, SKPMSHCK 4693/2018, të datës 15.08.2018, njofton për anulimin e procedurës së rekrutimit për pozitën Drejtor në Departamentin e Kulturës, të shpallur me datë 27.04.2018, me Nr. të Ref. 13/2018.

### OBAVEŠTENJE O ANULIRANJU KONKURSA

Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta, bazirajući se na Odluku Nezavisnog Nadzornog Odbora Civilne Službe Kosova, Br.175/2018, datuma 10.08.2018, SKPMSHCK 4693/2018, datuma 15.08.2018, obaveštava o anuliranju procedure regrutivanja, o poziciji Direktora Departmana Kulture, objavljen datuma 27.04.2018, sa Br. Preporuke 13/2018.

# AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla  
"RITMO - L"  
Prishtinë**

**Eksperienca jonë  
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:  
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

**Tel / kontakt:**

**044 248 173**

**044 200 604**

**044 375 333**

**RESTAURANT**

**SWISS**

**TAVERNA**


**Tel: +377 45 400 156**

**+386 49 848 553**

**Prishtinë**

**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898  
Sallon Depilimi Lume's Details  
lumesdetails  
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



## OFERTË PËR SHITJE TË SHTËPISË

Shitet shtëpia dykatëshe, me sipërfaqe prej 218 m<sup>2</sup>, dhe trualli me sipërfaqe prej 410 m<sup>2</sup>.

Shtëpia gjendet në Prishtinë, në lagjen "Aktash I", rr. "Ferhat Draga" nr. 1.

Procedura e transaksionit nga shitësi te blerësi bëhet pas nënshkrimit të kontratës së shitblerjes dhe pagesës së çmimit të kontraktuar, pastaj paluejtshmëria e përshkruar më lart kalon te blerësi.

Çmimi sipas marrëveshjes.

**Informata më të hollësishme mund të merren në numrin e telefonit 001-347-331-8305 në Nju Jork, kurse në Prishtinë në celularin 044-166-580.**

## OFERTE PËR SHITJEN E PATUNDSHMËRISË

Blerim (Nuredin) Berisha, me banim në fshatin Poslisht K.K. Prizren i pajisur me letërnjoftim - numër personal: 1006612608 të lëshuar nga MPB e Kosovës - Prishtinë, është bashkëpronar me pjesën prej 185/285 e pjesës ideale të patundshmërisë, me numër të Njësia Kadastrale P.nr. 71813067-00566, në vendin e quajtur "Llofka - Llofka", me kulturë bujqësore arë e kl. 4, në sipërfaqe të përgjithshme prej 2851 m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale Poslisht.

Nga pjesa e vet ideale i fron për shitje sipërfaqen prej 500 m<sup>2</sup> të patundshmërisë me të dhënat si më lart, në shumën prej 1.000 € për një ari, përkatësisht në shumën e përgjithshme prej 5.000 €, (me shkronja: Pesë mijë euro).

Prizren: 15.08.2018

Ofertuesi: Blerim Berisha

## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook [www.facebook.com/giejpuneshpeite](http://www.facebook.com/giejpuneshpeite)

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Zahit Uka shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme teknike "Anton Çetta" Skenderaj.

► Lëshoj banesën me qira. Banesa gjendet në qendër të qytetit në Prishtinë, në sheshin "Zahir Pajaziti". Banesa është e mobiluar dhe është me nxemje qendrore dhe ka 70 m<sup>2</sup>. Çmimi sipas marrëveshjes. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-171-328.

► Lëshoj banesa me qira afër Eulex-it, ish Farmedi, në lagje të spitalit, banesa është e lirë që nga data 01.08.2018. Banesat janë të ndërtuar nga kompania "Cima Contrekshen" njëra banesë ka 112 metër katror ndërsa tjetra 85 metër katror. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 044-923-527 dhe 044-402-679.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira për një person të huaj, Banesa duhet të jete jo shumë larg qendrës, mundësisht tek "Qafa" ose "Tophane" Duhet të ketë dy dhoma gjumi, të jete e mobiluar bukur. Çmimi deri 300 euro. Për info: Tel 049-472-770

► Lëshoj me qira banesën në Prishtinë, Lagja Mati 1, rr. Ndue Perllushi (pas 13 katshes). Banesa ka 58 m. katrorë, e mobiluar. Nr. kontaktues 044-121-668 ose 044-172-938. Çmimi sipas marrëveshjes.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Fushë Kosovë, për një familje 3 anëtarësh. Banesa duhet të ketë 2 dhoma gjumi, dhomë dite, kuzhinë dhe poashtu të jetë e mobiluar. Banesa kërkohet për afat më të gjatë. Info në tel: 044-741-151

► Urgjentisht kërkoj banesë me qira për një çift në Fushe Kosove. Banesa duhet të ketë një dhomë gjumi dhomë dite me kuzhinë te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

► Urgjentisht kërkoj banesë me qira në Prishtinë, për një çift me një fëmijë. Banesa duhet të ketë 1 dhomë gjumi dhomë dite me kuzhinë. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

► Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

► Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.



ROYAL CROWN



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

**Quality & Sales Award Recipients**  
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

